PËRMBAJTJA


6 Kalaja merret nga brenda jo...



8 Intervistë me Hasan Pretenin


14 Kush e futi laicizmin në...


22 Vepra dhe shkaqet e vrasjes...


30 Për maturantët dhe studentët...

Portreti i muajit: Berisha, kryeministri i shqiptarëve... 2
Avni Avdiu: Ani piktor Gërba!!!... 3-4
Agim Fazliu: Edhe pas luftës "luftë" 4-5
Zhvillohet fushata parazgjedhore 5
Avni Xhemajli: Kalaja merret nga brenda jo nga jashtë 6-7
Fotolajm 7
Intervistë me Hasan Pretenin 8-9
Fatos Shala: Plot një muaj fushatë kundër trafikimit të njerëzve 10
Emine A. Vezaj: Roli i edukatës fetare 11-13
Prof. dr. Fadil Maloku: Kush e futi laicizmin në Kushtetutën e Kosovës? 14-16
Mimoza Sinani: Triumfi delirant i marshimit ateist .. 17-19
Intervistë me Egemen Bagis 20-21
Muhamed J. Kajolli: Vepra dhe shkaqet e vrasjes së Osmanit r.a. 22-25
Letër anonime 26-27
Iljasa Salihu: Sfidat e njeriut bashkëkohor përballë rreziqeve madhore! 28-29
Mevlude Zejnullahu: "Paqja Studentore" në mesin tuaj 29
Jeton Isufi: Për maturantët dhe studentët e rinj... 30-31
Faik Konica: Këshilla një gazetari 31
Blerina Rogova – Gaxha: Rrëfim mbi shekullin e humanistit 32-33
Flamur Maloku: Tiparet shënjuese 33-34
Astrit Veliqi: Kultura dhe shtypi ditor në Kosovë .. 34-35
Poezi 35
Aforizma 36
Iliriana Alloqi & Bernard Tahirbegolli: Apendiciti (zorra qorre) mund ta marrë jetën 37-38
Alban Bilalli: Cila është më e mirë në botë? 39
Fjalëkryqi 40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti IV / Nr. 35
19 tetor - 19 nëntor 2009
Botues
Zëri Ynë
O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës
Avni AVDIU
avni.avdiu@gmail.com

Redaktor i kulturës
Flamur MALOKU
flamurmaloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore
Mimoza SINANI

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@hotmail.com
http://www.zeri-yne.org

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14, përballë teatrit Dodona, Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

Portreti i muajit

Berisha, kryeministri i shqiptarëve

Lindur më 15 Tetor 1944, në Tropojë. Ka mbaruar Univeristetin e Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë. Pas studimeve të avancuara në Paris (Francë), drejtoi një program kërkimor për Hemodinamikat, ndërsa në vitin 1986, zgjidhet anëtar i Komitetit Evropian për Kërkime në Shkencat Mjekësore. Ishte pedagog në Universitetin e Tiranës në vitet 1980-1990. Ndër themeluesit e Partisë Demokratike, në dhjetor të vitit 1990, kryetar i saj në vitet 1991-1992. Deputet në kuvendin popullor prej 31 mars 1991 deri më 9 prill 1992. Ka qenë President i Republikës së Shqipërisë në vitet 1992 - 1997. Prej 21 tetorit 1997 vazhdon vetëm si kryetar i PD-së. Prej 24 korrik 1997 vazhdon si deputet në kuvendin e Shqipërisë dhe prej 3 shtatorit 2005 kryeministër i vendit, tani në mandatin e dytë.

Pa mëdyshje edhe kësaj radhe u dëshmua se kryeministri i Shqipërisë Sali Berisha gëzon respekt të madh në Kosovë. Ai u prit nga qytetarët e Kosovës me entuziazëm të papërshkruar. Simpatia ndaj liderit demokrat u shtua edhe më tepër nga kryevepra që doli gjatë mandatit të tij, autostrata Durrës-Kukës-Morinë, segmenti Rrëshen-Kalimash që afron edhe më shumë Kosovën me Shqipërinë. Presidenti i Kosovës Fatmir Sejdiu, duke pasur parasysh kontributin e jashtëzakonshëm që ka dhënë për çështjen shqiptare e në veçanti për Kosovën e pavarur e demokratike, dekoroi kryeministri e Shqipërisë, me “Medaljen e Artë të Lirisë”, të cilën vetë Berisha e konsideroi si nderimin më të madh që i bëhej atij. Kryeministri Berisha e pranoi medaljen pas një fjalimi që mbajti para deputetëve të Kuvendit të Kosovës në një seancë solemne. Në kuvend, Berisha tha se bashkimi kombëtar i shqiptarëve do të jetësohet brenda strukturave të Bashkimit Evropian. Ndërsa vetë prezencën e tij në Kuvendin e Kosovës, ai e përjetoi shumë emocianalisht, për faktin se siç tha, ishte hera e parë që u drejtohej ligjvënësve të Kosovës së pavarur. Pastaj me organizimin e një ceremonie solemne Universiteti i Prishtinës e nderoi me titullin “Doctor Honoris Causa”. Rektori Mujë Rugova tha se titulli “Doctor Honoris Causa” i UP-së për Sali Berishën është një ditë e veçantë dhe kjo i nderon të gjithë qytetarët e Kosovës. Me motivacionin për kontributin e tij të jashtëzakonshëm për çështjen shqiptare, Berisha u nderua edhe nga Kuvendi Komunal i Prizrenit me titullin "Qytetar nderi" i qytetit të Prizrenit. Kryeministri Berisha bëri homazhe te varri i ish-presidentit Ibrahim Rugova, pastaj vizitoi familjen Rugova, ku u takua me bashkëshorten dhe fëmijët e presidentit të ndjerë. Berisha bashkë me kryeministrin e Kosovës Hashim Thaçin vizituan kompleksin memorial ‘Adem Jashari’ në Prekaz dhe familjen Jashari. Kryeministri i Shqipërisë vizitoi edhe monumentin ‘New Born’, duke vazhduar takimet me zyrtarë ndërkombëtar – përfaqësuesin e BE-së Piter Feith dhe komandantin e Kforit gjeneralin Markus Bentler ■



Ani piktor Gërba!!!...



Avni AVDIU

Maqedonia për shqiptarët është bërë si trekëndëshi i Bermudës. Në këtë vend plekset shumëkëndëshi i nënçmimit, injorimit dhe poshtërimit të shqiptarëve nga njëra anë dhe pezmi, hidhërimi dhe indinjata e thellë e tyre nga ana tjetër. Ky rrymim po çon dallgë të mëdha në Gadishullin Ballkanik. Vendi rrezikon të fundoset, ashtu siç ndodhi me anijen Ilinden, para pak javësh në ujërat e Ohrit. Zaten është kjo një metaforë për Marrëveshjen e Ohrit, e cila s'është askurrkah.


U tha shumëçka për Enciklopedinë. Realisht ajo ishte një enciklоPADI kundrejt shqiptarëve. Ndaj tyre u shfre një staf kuazishkencor. 'Akademia' i lejoi përmes redaktorit Blazhe Ristevski, njëfarë Mallkovskit që t'i përçudnojë shqiptarët, duke i përshkruar si njerëz mali. Mallkovski me mallkim kishte harruar ta kopjojë prej serbëve idenë se shqiptarët kanë edhe bishta. Po serbët megjithatë nuk ia panë për të madhe. Serbia u nda e kënaqur nga enciklopedia maqedonase, sepse ishte kopje besnike e ideve të Garashaninit, Çubriloviçit, Andriqit, Qosiqit etj. Ishte kjo një reflektim i urrejtjes patologjike që daton nga dy Llazarat maqedonas (Kolishevski e Mojsov). Enciklopedia ishte shfrim i dufit histerik, e jo argument historik, ishte thjesht skandal shkencor. Befasia ishte se si arriti kjo në instancat akademike. Përndryshe, për shqiptarët, kjo s'është risi. Janë maqedonasit ata që të pezmatuar nga sulmet e NATO-s ndaj Serbisë, klithnin "vdekje shqiptarëve", "do t'i vrasim shqiptarët" etj., parulla këto të cilat mund t'i lexosh në shumë mure ndërtesash në formë grafite, i gjuanin ambasadat e huaja me gurë, digjnin flamurin e NATO-s, e bënin lloj-lloj veprimesh të pahijshme. Prandaj s'është për t'u çuditur sot kur del enciklopedia dhe e quan Uesli Klarkun agresor, kurse Serbinë viktimë. Thuhet se edhe UÇK-re u stërvit nga amerikanët dhe britanikët, për t'u demantuar më pas nga ambasadat e këtyre vendeve si pohime të pabaza.

Mirëpo kjo enciklopedi s'dëmton askënd më shumë se vetë maqedonasit. Atyre Bullgaria nuk ua njeh gjuhën, historinë, kombin. Serbia nuk ua njeh kishën ortodokse dhe Greqia emrin. Shqipëria dhe Kosova ua njohin të gjitha, ndërsa maqedonasit vazhdimisht ua kanë bërë dhe ua bëjnë shqiptarëve atë që atyre ua bëjnë bullgarët, serbët dhe grekët. Ne po i mbivlerësojmë ata që vazhdimisht po na nënçmojnë, ata që shfrejnë mllefin e grumbulluar ndaj të tjerëve, vetëm ndaj nesh. Enciklopedia në raport me MO ishte: 'merrja bukën e harron djathin!'. Se është shkruar me pasion dëshmon deklarata e redaktorit dhënë 'Politikës' së Beogradit se nuk e ka ndërmend të tërhiqet mbrapa. Shkencëtari nuk do të thoshte ashtu, sepse njeriu i dijes hesht përballë argumenteve dhe tërhiqet me xhentilencë kur gabon. Mund të ketë shkencë që merret me politikë, por politika s'bën të merret me shkencë. Problemi logjik është: mbase na paskan ardhur shqiptarët prej mali, po para se të ishin në male nga erdhën – pikën prej qiellit me parashutë. Në qoftë se paskëshin ardhur aq vonë shqiptarët këtu, atëherë kush i mbolli nën tokë gjithë ato gjetje arkeologjike ilire në trevat e Ohrit, Pellagonisë, Shkupit etj. Madje vetë gjurmuesi maqedonas Vasil Iljov, në fshatin Osniçan, 13 km afër Shkupit, ka gjetur pllakë me alfabet etrusk që përdorej nga pellazgët, paraardhësit e ilirëve. Prandaj autoktonia e shqiptarëve s'mund të jetë kalkulim politik e romantik, por është dëshmi e argumentuar shkencërisht me fakte arkeologjike. Historia maqedonasve po u sillet rreth qafe herë në formë tragjike, kur u ndanë dhe tani në formë komike, kur po kanë probleme me veten, nuk e dinë çka e kush janë. Ata janë në tehun e polemikës më paradoksale për identitetin e tyre kombëtar: herë thonë janë antikë, e herë sllavë. Dëshira për të qenë antikë lidhet me autoktoninë, kurse për të qenë sllavë me aleancat vëllazërore. Shtrohet pyetje nëse janë antik, atëherë çfarë trashëguan prej tyre tjetër, përveç dëshirave dhe iluzioneve për t'i ngjasuar me çfarëdo qoftë kushti, qoftë në përvetësimin e figurave, apo të simboleve historike? Nëse s'janë sllavë, atëherë pse e përdorin alfabetin cirilik, apo pse ngjason gjuha e tyre me gjuhët e tjera sllave? Këtyre pyetjeve është dashur t'u përgjigjej enciklopedia. Akademikët do të duhet të kishin qenë të vetëdijshëm se çfarë gërbe mbajnë në shpinë. S'u ka mbetur atyre të



merren me shqiptarët, sepse shqiptarët e dinë kahmoti autoktoninë dhe identitetin e tyre të pranuar nga qarqet më relevante shkencore të botës. Ne e dimë çka jemi e kush jemi dhe s'ka mbetur të na tregojnë neve historinë ata që nuk e dinë historinë e tyre. Shikuar hollë e hollë, maqedonasit duhet t'ia dinë për nder Titos që i sajoi si shtet më vete.


Ajo që duhet ta vrasë sot shqiptarin e ndershëm nuk është enciklopedia maqedonase, por kompaktësia jonë kombëtare. Pjesëmarrësi shqiptar i hartimit të enciklopedisë Agim Poloska TvAlsatM deklaroi në lajme se enciklopedia është një nismë e mirë dhe jo e përkryer, gjë që s'do koment. Maks Velo në TvKlan në Opinion deklaroi se krejt fajet në Maqedoni i kanë shqiptarët se i kanë drejtuar minaret si raketat e Iranit, kurse shumë shqiptarë në Shqipëri, e më pak në Kosovë, shqiptarët e Maqedonisë i quan maqedonas (p.sh gazeta 'Panorama' 1 korrik 2009, f.16: Vdes në Ilixhat e Dibrës 84 vjeçari maqedonas Latif Zenki nga Gostivari; ose lajmi tjetër: 'Panorama' 7 korrik 2009, f.11: 'Asnjë gjurmë për maqedonasin e zhdukur Isak Ademi'.). Pastaj ku e kanë shqiptarët enciklopedinë e tyre?! Kur po ndodhin gjërat po kapim kryet me grushte e po themi: 'kuku, çka u bë!' Enciklopedia maqedonase, tekefundit, nuk është aq problem i madh për ne. Ajo ma kujton një humor të Rasim Thaçit në produksionin e tij 'Supercima', ku i thonë: 'Kuku, Cimës iu paska zvogëlue kryet - i thonë disa. Por Cima më së shumti revoltohet kur i thotë njëfarë piktor Gërba. Pastaj Cima thotë në vetvete: 'Kuku nane, ani piktor Gërba um thojke t'u ka zvogle kryet, haj kuku nane, ai s'e shifke gërbën e vet'. Ky humor metaforikisht pasqyron këtë problematikë. Neve njëmend ndoshta na është zvogluar pak kryet (se s'po punojmë ta kishim moti enciklopedinë tonë e po flejnë akademikët tanë), por edhe maqedonasit e kanë goxha gërbën e madhe (probleme të shumta me identitetin e tyre). ■





Fshati Tanushë mbetet jashtë kontrollit të shtetit maqedonas

Edhe pas luftës



Agim FAZLIU

Shumë ish-luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK), të cilët kanë akuza të ndryshme nga gjykatat maqedonase, janë barrikaduar në fshatin Tanushë. Këtu janë duke përjetuar një luftë të dhimbshme shpirtërore, pasi po përjetojnë një luftë pas luftës. Është më shumë një luftë nervash

TANUSHË, SHKUP, TETOR -

I barrikaduar në vendlindjen e tij, Xhezair Shaqiri nuk e sheh dot fundin e izolimit. Për tre vjet, në fshatin Tanushë është duke përjetuar një luftë të dhimbshme shpirtërore. Shpeshherë pëshpërit fjalët inshAllah nuk zgjat shumë kjo gjendje. Thotë se vetëm Zoti e di si do marrë fund kjo gjendje. Lutet që të përfundojë sa më shpejt.

Është vendosur këtu bashkë me shumë ish-luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK), të cilët kanë akuza të ndryshme nga gjykatat maqedonase. Shaqiri, i njohur si komandant Hoxha, është paditur nga një gjykatë maqedonase për përfshirje në



Xhezair Shaqiri: Duhet të ndryshojë qasja politike ndaj shqiptarëve



Fshati Tanushë mbetet jashtë kontrollit të policisë maqedonase

një rrëmbim. Pas kësaj, ai u detyrua të barrikadohet në Tanushë, për t'i shpëtuar arrestimit. Këtu kanë ardhur vazhdimisht djem të rinj që nuk pranonin të pësonin fatin e afro 300 ish-luftëtarëve që janë burgosur, të akuzuar për vepra të ndryshme penale.

Luftëtarët e rinj, këtu, kanë rrokur armët për të mos lejuar futjen e policisë maqedonase në brendësi të fshatit Tanushë, i cili ndodhet disa kilometra larg kufirit midis Kosovës dhe Maqedonisë.

Për tre vjet, këtu është krijuar një zonë e ndaluar për autoritetet e shtetit maqedonas. Por, Xhezair Shaqiri nuk ndihet mirë nga fakti që është detyruar të krijojë një zonë jashtë kontrollit shtetëror. E hidhëron fakti që në mediat maqedonase personifikohet si prishës e rendit dhe i qetësisë. "Gjatë kohës sa e mbajmë nën kontroll situatën këtu nuk ka pasur krime. Gjithçka ka funksionuar sikur të ketë pasur një strukturë të mirëfilltë shtetërore".

U barrikaduan për shkak të sulmeve të policisë maqedonase

Shaqiri tha se kanë qenë sulmet e forcave të sigurisë maqenonase në fshatin Tanushë, që kanë ndikuar për barrikadimin e luftëtarëve shqiptarë në këtë fshat. Policët maqedonas patën bastisur dhunshëm disa shtëpi në Tanushë. Pas kësaj, djemtë rrokën armët dhe tashmë nuk lejojnë afrimin e patrullave policore. Xhezair Shaqiri, tha se armët kishin mbetur e vetmja alternativë për kundërshtimin e asaj që quhet politikë diskriminuese maqedonase ndaj shqiptarëve. "Sipas Marrëveshjes së Ohrit, parashikohej që për një periudhë të shkurtër të zgjidhej çështja e përdorimit të flamurit dhe të gjuhës shqipe. Po bëhen tetë vjet dhe kudo nëpër vendbanimet shqiptare ka probleme për realizimin e kushteve që janë paraparë gjatë marrëveshjes për përfundimin e luftës në Maqedoni". Shaqiri tha se ata e kanë vendosur flamurin kombëtar shqiptar në pikat e larta të fshatit Tanushë. Atë e mbrojnë luftëtarët e armatosur.

Komandant Hoxha është i bindur se rezistenca e tyre në shume rase ka ndikuar edhe për zgjidhjen e disa çështjeve politike. Ai ka ndërmjetësuar për sqarimin e disa mosmarrëveshjeve rreth përcaktimit të kufirit midis Kosovës dhe Maqedonisë. Në disa raste tjera, Xhezair Shaqiri ka luajtur rol vendimtar për zgjidhjen e disa rasteve të rrëmbimeve. Ky aktivitet paqësor i komandantit gueril e ka përmirësuar imazhin e tij te përfaqësuesit ndërkombëtarë.

Armiqësia përfundon nëse ndërrohet qasja diskriminuese

Edhe gjykatësit maqedonas kanë dhënë shenja se do të mund të anulonin padinë kundër tij. "Më kanë thënë që vetëm të paraqitem në gjykatë. Por, këtë nuk e bëj, sepse nuk u besoj gjykatësve maqedonas". Shaqiri tha se për të fituar besimin, autoritetet maqedonase duhet të investojnë në zonat e populluara nga shqiptarët, sidomos në pjesën afër kufirit me Kosovën. Nëse do të ndodhte kjo, edhe luftëtarët shqiptarë do të ulnin armët dhe do të integroheshin në shoqëri.

Por, sipas Komandant Hoxhës, deri tash politika maqedonase nuk ka dhënë shenja se do t'i pranojë shqiptarët. Vetë Shaqiri, për tre vjet ishte deputet i Parlamentit të Maqedonisë nga radhët e Partisë Demokratike Kombëtare. Gjatë kësaj kohe ai kërkoi me ngulm përmirësimin e të drejtave të shqiptarëve. "Në njëfarë mënyre jam zhgënjyer nga aktivitetet politike. Duhet që të ndryshohet qasja me të cilën deri tash janë trajtuar shqiptarët"- tha Shaqiri.

Thirrja e komandantit të Tanushës nuk ka ndikuar për relaksimin e raporteve. Luftëtarët shqiptarë vazhdojnë të mbajnë pozicionet e tyre në pikat më të larta të fshatit. Disa herë ata kanë zmbrapsur forcat maqedonase. Ata janë duke e përjetuar edhe një luftë pas luftës së vitit 2001. Të izoluar vetëm në një fshat, ata e përjetojnë më dhimbshëm këtë lloj lufte. Është më shumë luftë nervash. ■

Zhvillohet fushata parazgjedhore

Ka filluar dhe është duke u zhvilluar fushata zgjedhore për zgjedhjet lokale të nëntorit. Këto zgjedhje janë të një rëndësie të veçantë, sepse Kosova për herë të parë në pavarësi si republikë më vete organizon vetë zgjedhje të lira. Organizimi i zgjedhjeve në Kosovë që nga paslufta ka qenë përgjegjësi e OSBE-së, ndërsa kësaj radhe Komisioni Qendror Zgjedhor është institucioni kryesor për organizimin e zgjedhjeve, ndërsa organizatat dhe vëzhguesit e huaj do të kenë vetëm rolin e monitorimit. Ky është një provim i vështirë përpara bashkësisë ndërkombëtare, që duhet kryer me sukses.

Partitë politike të certifikuara nga KQZ-ja do të garojnë për 30 ditë rresht për zgjedhjet lokale të 15 nëntorit. Ato do të shpalosin programin e tyre para elektoratit, me ç'rast do të mundohen t'i bindin ata për të marrë votëbesimin për një mandat të ri katër vjeçar në drejtimin e komunave të Kosovës. Megjithëse kampanja filloi zyrtarisht më 15 tetor, atë disa parti politike e filluan shumë më përpara. Tashmë siç bëjnë të ditur përfaqësuesit e partive politike përgatitjet për këtë fushatë janë në nivel dhe madje janë bërë të ditura edhe lokacionet dhe koha e mbajtjes së tubimeve parazgjedhore.

Zyrtarët e policisë kanë siguruar se kanë përgatitur planin operativ për ofrimin e sigurisë gjatë fushatës. Përfaqësuesit e institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare kanë shfaqur interesimin e tyre që gjatë procesit zgjedhor të dëshmohet pjekuri e lartë politike. Partitë politike janë zotuar për fushatë korrekte, duke nënshkruar për këto zgjedhje lokale edhe Kodin e Mirësjelljes, me të cilin obligohen që të zhvillojnë një fushatë dinjitoze parazgjedhore. Andaj në ditët në vijim mbetet të shihet se partitë politike a do t'i zbatojnë në vepër zotimet e tyre me fjalë për të zhvilluar fushatë demokratike. Në garë për zgjedhjet e 15 nëntorit janë 74 subjekte politike, nga të cilat 37 janë subjekte politike shqiptare, 21 serbe dhe të tjerat i përkasin komuniteteve tjera pakicë.■

Kalaja merret nga brenda jo



Avni XHEMAJLI



Edi Rama

Vaji dhe zhurma e së majtës dhe sidomos e kreut të saj Edi Rama në Shqipëri për humbjen e Helenës në 2005-ën vazhdon të jetë e madhe; të cilën atëkohë ia kishte rrëmbyer e djathta e Sali Berishës. …Kësaj radhe Edi Rama nuk ia doli ta kthejë atë në kalanë e socialistëve që prej kohës kur ajo e kishte braktisur atë. Për pasojë, kreu i socialistëve ende s'po mund ta rimarrë veten nga plagët që pësoi në betejën e 28 qershorit, humbje e cila duket se e ka goditur rënd në thembër.

Mospajtimin e tij me epilogun e 28 qershorit Edi Rama po e shpreh me bojkotimin e parlamentit, gjë me të cilën kreu i socialistëve si duket ju ka dhënë deputetëve të partisë së tij 'pushimin më gjatë e më të mirë' që kanë mundur ta kenë pasur ndonjëherë. Prej asaj dite, karriget dhe tavolinat e deputetëve të partisë socialiste vazhdojnë të qëndrojnë të boshatisura në Kuvendin e Shqipërisë; e që në vend së Edi Rama të kthehet në parlament dhe betejën e tij politike ta zhvillojë nga brenda, ai vazhdon të qëndrojë jashtë, duke i ftuar anëtarët dhe përkrahësit e PS-së të dalin në protesta, e të bëjnë zhurmë, shumë shumë zhurmë, rrugëve e nëpër sheshe.

Por, kush e ka lexuar "Iliadën" e Homerit ose e ka shikuar filmin e Trojës ndonjëherë, ka pasur rastin të kuptojë dhe ta sheh se kalaja merret nga brenda. Por si duket Edi Rama nuk e ka lexuar "Iliadën", kurrë dhe as që e ka shikuar filmin "Troja" ndonjëherë. Po ta kishte bërë këtë gjë, me siguri se prej saj, tani do të kishte nxjerrë një mësim të dobishëm për vete; se kalaja merret nga brenda e jo nga jashtë dhe me ç'rast do të kuptonte se do të duhej të futej në parlament dhe betejën ta zhvillojë nga brenda e jo nga jashtë, siç është duke bërë tani.

Por, faktin se kalaja merret nga brenda dhe jo nga jashtë, duket se më së miri e kuptoi kreu i demokratëve Sali Berisha. Sidoqoftë, përpos kësaj, ai e kuptoi dhe e vërejti edhe diçka tjetër, se kalaja e tij përveç që mund të mbrohet nga brenda ajo mund të mbrohet edhe nga jashtë. Për këtë arsye ai vendosi të zgjerojë koalicionin e tij përtej se djathtës, duke e ftuar në koalicionin e tij të majtën e Ilir Metes. Me pranimin e ofertës nga Meta dhe me formimin e qeverisë së re të integrimit evropian, Berisha si duket e goditi rënd në thembër Edi Ramën, duke e mbajtur kështu Helenën edhe për rreth katër vite larg duarve të tij.

Berisha pra, me zgjerimin e koalicionit dhe me zemërgjerësinë e tij të treguar ndaj LSI-së dhe veçanërisht ndaj Ilir Metës, i cili përveç që gëzon postin e zv.kryeministrit, ai tani e ka edhe njërin prej dikastereve më të rëndësishme LSI-ja arriti maksimumin e mundshëm. Më këtë gjë, Berisha duke kënaqur dëshirat e partnerit në koalicion, ka ngritur një kala të fuqishme, e cila vështirë se do të mund të merret nga protestat e Edi Ramës me zhurmë, shumë shumë zhurmë, shesheve e rrugëve të Tiranës.

Protestat të organizuara nga Edi Rama rrugëve e nëpër sheshe në fundjavën e kaluar ishin të zbehta. Ato nuk i treguan efektet e dëshiruara për të ndryshuar diçka në të mirë të socialistëve. Prandaj qëndrimi jashtë parlamentit i Edi Ramës nuk mund ta kthej humbjen në fitore, madje as hapja e kutive të zgjedhjeve. Fitorja pra nuk mund të kthehet duke qëndruar jashtë parlamentit, por duke u futur brenda tij, sepse përveç tjerash, pushteti në demokraci merret nga brenda e jo nga jashtë. Ndërsa udhëheqja dhe politikbërja me autoritarizëm e arrogancë që bën Edi Rama i takojnë të kaluarës. Duhet ditur pra se me arrogancë dhe kokëfortësi nuk mund të bëhet më



Qeveria e koalicionit Berisha - Meta

nga jashtë

Ndërsa udhëheqja dhe politikbërja me autoritarizëm e arrogancë që bën Edi Rama i takojnë të kaluarës. Duhet ditur pra se me arrogancë dhe kokëfortësi nuk mund të bëhet më politikë në kohën që po jetojmë. Prandaj zhurma e Edi Rames do të duhej të zhvendosej nga sheshet e rrugët e të kalojë në parlament. Për ndryshe, thembra e Edi Rames rrezikon ta marrë në qafë të gjithë partinë e tij

politikë. Prandaj zhurma e Edi Rames do të duhej të zhvendosej nga sheshet e rrugët e të kalojë në parlament. Për ndryshe, thembra e Edi Rames rrezikon ta marrë në qafë gjithë partinë e tij.

Qëndrimi jashtë parlamentit më shumë se askënd tjetër e dëmton dhe e rrezikon drejtpërsëdrejti Partinë Socialiste dhe atë në rrezikimin e humbjes se anëtarësisë dhe elektoratit që lehtësisht -duke parë ngecjet e PS-së- të kalojnë në taborrin e të majtës tjetër, atë të Ilir Metës, i cili tani nën ombrellën e përbashkët djathtisto-majtiste po tregon një pjekuri politike dhe një performancë të mirë prej lideri. Dhe rreziku për PS-në mund të ashpërsohet edhe më shumë, në qofë se, nga pakënaqësia e qëndrimeve të kreut të saj Edi Rama, duke mbajtur pezull partinë për të mos shkuar në parlament, të zgjohet ndonjë rezistencë brenda PS-së dhe të copëtojë prapë ndonjë pjesë prej saj, siç ndodhi vite me parë me Ilir Meten e që në betejën e fundit të majtës i kushtoi mjaft shtrenjtë.

Qëndrimi jashtë parlamentit edhe për arsye të tjera nuk është zgjidhje, sepse gati gjysma e Shqipërisë nuk mund të mbetet peng e një lideri autokrat e të qëndrojë jashtë parlamentit; sepse përveç tjerash, bojkoti i Ramës duke qëndruar jashtë parlamentit, prolongon edhe punën e kuvendit. Për këtë arsye edhe Komisioni Evropian edhe ambasadorët e shteteve të ndryshme në Tiranë, i bënë thirrje atij të mos qëndrojnë jashtë, por të futet brenda në parlament që të vazhdohet me zhvillimin e mëtutjeshëm të vendit, në nxjerrjen e ligjeve dhe vazhdimin e reformave që e ofrojnë vendin drejt integrimit evropian.



Edi Rama - kreu i opozitës në Shqipëri

Kthimi i Edi Rames në parlament do të ishte më i mirë për të, me gjithë zhgënjimin e dhimbjen për mosarritjen e synimeve për ta kthyer Helenën përsëri në kalanë e socialistëve. Por megjithatë kthimi i tij do të ishte një çlirim dhe një fillim i ri për të, sepse siç thotë Kadare, më mirë një fund i dhimbshëm së sa një dhimbje e pa fund.

Në ndërkohë Edi Rama ndoshta do të marrë pak kohë dhe të lexojë "Iliaden" ose së paku ta shikojë filmin "Troja" dhe me ç'rast të kuptojë se kalaja mirret nga brenda dhe jo nga jashtë, që me këtë gjë të përgatitet më mirë për kthimin e Helenës më 2013. …Deri atëherë, ai duhet të mjaftohet me postin e kryebashkiakut të Tiranës nëse nuk pëson ndonjë "shkurorëzim" të papritur më 2011, që me ç'rast zhurma e Berishës do të ndalej edhe më shumë, ndërkohë që zhurma e Edi Ramës do të bëhej edhe më e madhe. ■

FOTOLAJM



Studentët e UP-së të cilët nuk banojnë në konviktet e Qendrës Studentore, detyrohen që triskat për t'u ushqyer në mensë t'i tërheqin nëpërmjet dritareve, pasi që sipas zyrtarëve po u përzihen dokumentet me të atyre që banojnë në konvikte. Për më tepër flet fotografia! B.I.

Intervistë me Hasan Pretenin, drejtor i Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit

Preteni, Kosova ende me shk

Intervistoi: Astrit VELIQI


Hasan Preteni

Korrupsioni edhe me tej mbetet sfida më e madhe e qytetarëve kosovarë, andaj nevojitet një angazhim edhe më i madh në vetëdijesimin e qytetareve në lidhje më pasojat që shkakton korrupsioni në jetën e tyre, Këtë fakt e bënë edhe më të besueshëm 'raporti i progresit' i Komisionit Evropian, i cili thotë se numri më i madh korrupsionit i përket rasteve që kanë të bëjnë me zyrtarët e Qeverisë, ndërmarrjeve publike, gjykatave dhe pushtetit lokal etj.

Për të gjitha këto dhe për shumë sfida, probleme, por edhe ta arritura për revistën " Paqja", flet më gjerësisht Hasan Preteni, drejtor i Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit

PAQJA: ***z. Preteni Sa raste i ka hetuar Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit në Kosovë në vitin 2009; cili është niveli i korrupsionit në këtë vit, krahasuar me vitin e kaluar përkatësisht vitin 2008?***

Hasan Preteni: Sa i përket vitit 2009, Agjensioni do të përgatisë Raportin Vjetor për vitin 2009, në të cilin do të paraqiten të gjitha të dhënat në lidhje me numrin e rasteve të pranuara për dyshime korruptive, numrin e rasteve të dërguara në Prokurori si dhe numrin e rasteve të mbyllura për mungesë provash, por mund të them se ka rritje të rasteve të paraqitura krahasuar me vitin 2008.

PAQJA: ***Sipas juve sa është rritur vetëdija te qytetarët për t'i denoncuar rastet e korrupsionit në Kosovë?***

Hasan Preteni: Duke pasur parasysh se ka rritje të numrit të rasteve për dyshime korruptive të raportuara nga qytetarët në Agjension, mendoj se ka filluar të ngritët vetëdija e qytetarëve për denoncimin e këtyre rasteve, por nevojitet angazhim edhe më i madh në vetëdijesimin e qytetarëve në lidhje më pasojat që shkakton korrupsioni në jetën e tyre.

PAQJA: ***Në "Raportin e progresit" që e ka sjell Komisioni Evropian në Kosovë, në bazë të përmbajtjes së tij, del se në Kosovë ka nivel të lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar, ju si drejtor i agjensionit antikorrupsion si e vlerësoni këtë fakt?***

Hasan Preteni: Sa i përket shkallës së korrupsionit në Kosovë, ju them se sipas informacioneve që disponon Agjensioni në Kosovë ekziston një shkallë e lartë e korrupsionit dhe këtë e themi jo vetëm ne, por edhe sondazhet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Mjafton t'i referohemi raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2009 dhe kjo e sqaron çështjen e nivelit të korrupsionit në Kosovë. Në fakt informatat e Agjensionit flasin se korrupsioni është i shtrirë në institucionet e ndryshme dhe në nivelet e ndryshme. Është shumë e nevojshme që mekanizmat përgjegjës për luftimin e kësaj dukurie e në

kallë të lartë të Korrupsionit



radhë të parë organet e gjyqësisë dhe prokurorisë, t'i ndërmarrin të gjitha masat që kjo dukuri të luftohet dhe të parandalohet në mënyrë adekuate dhe me këtë vendit t'i krijohet një perspektivë më e mirë dhe më e sigurt.

PAQJA: ***Sipas juve çka mendoni në cilat institucione ka nivel me të lartë të korrupsionit në Kosovë, në sektorin publik, privat apo gjetkë?***

Hasan Preteni: Raporti i Agjensionit për vitin 2008 e që është në ueb faqen e Agjensionit www. akk-ks. org flet se nga të gjitha informatat e dërguara për korrupsion në Prokurori, numri më i madh i përket rasteve që kanë të bëjnë me zyrtarët e Qeverisë, ndërmarrjeve publike, gjykatave dhe pushtetit lokal.

PAQJA: ***Ju si drejtor gjatë punës suaj, a keni pasur presion politikë, me një fjalë sa ka tendenca për të ndikuar politika në punën tuaj të pavarur për ta luftuar korrupsionin në Kosovë?***

Hasan Preteni: Sa i përket presionit mund të them se nuk ka pasur presion të drejtpërdrejtë, por Agjensioni dhe zyrtarët janë ballafaquar me mungesë të përkrahjes adekuate financiare, stimulimi i dobët për zyrtarët, të cilët punojnë në Agjension, etj.

PAQJA: ***Cili është bashkëpunimi i qytetarëve dhe cili është roli i tyre, sikurse edhe i mediave në zbulimin e rasteve të korrupsionit në Kosovë?***

Hasan Preteni: Sa i përket bashkëpunimit të qytetarëve, mund të them se ka një rritje të bashkëpunimit por mendoj se ky bashkëpunim duhet të rritet edhe me tepër, duke pasur parasysh rolin e madh qe kanë qytetarët dhe mediat për raportimin e rasteve të korrupsionit.

PAQJA: ***A ka raste që Agjensioni Antikorrupsion i ka dërguar në prokurori dhe sipas jush sa ato raste kanë filluar të kenë qasje te drejtë dhe a po hetohen në bazë të proceduarave të parapara me ligj në Kosovë?***

Hasan Preteni: Agjensioni për vitin 2007 dhe 2008 ka dërguar në prokurori 100 raste. Pre tyre janë arrestuar 3 persona, 12 raste janë konfirmuar se po hetohen nga prokuroritë kompetente, 4 aktakuza janë ngritur dhe për 69 informata nuk kemi përgjigje nga prokuroria me çka ne vlerësojmë se ato janë ende duke u trajtuar nga ana e prokurorisë. Pra siç shihet është e nevojshme të thellohet bashkëpunimi në mes të Agjensionit dhe prokurorisë me qëllim që për informatat e dërguara nga Agjensioni në prokurori të kthehen përgjigjet nga kjo e fundit.

PAQJA: ***Në çfarë niveli është bashkëpunimi juaj për çështjen e korrupsionit në Kosovë me EULEX-in dhe ICO-në, sa e gëzoni përkrahjen e tyre në këtë aspekt?***

Hasan Preteni: Sa i përket bashkëpunimit me EULEX-in dhe ICO-në, mund të them se e kemi një bashkëpunim të mirë. Kjo ilustrohet me faktin se Agjensioni e ka lidhur një memorandum të bashkëpunimit me EULEX-in, në bazë të cilit memorandum Agjensioni i ka dërguar disa informata për dyshime për korrupsion në Prokurorinë e EULEX-it, të cilat në bazë të vlerësimit të Agjensionit janë konsideruar si informata të ndjeshme dhe nga informacionet, të cilat i ka pranuar Agjensioni nga Prokuroria e EULEX-it, në shumicën prej tyre kanë filluar hetimet nga kjo Prokurori.

PAQJA: ***Cilat kanë qenë vështirësitë më të mëdha për t'i hetuar rastet e korrupsionit te ne, qëkur keni ardhur në pozitën e drejtorit të Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit në Kosovë?***

Hasan Preteni: Ndër vështirësitë më të mëdha për t'i hetuar rastet e korrupsionit kanë qenë mungesa e infrastrukturës ligjore, mosbashkëpunimi i duhur i institucioneve tjera si dhe mungesa e koordinimit ndërmjet organeve kompetente me qëllim zbulimin, ndjekjen dhe dënimin e personave të përfshirë në veprimtari korruptive.

PAQJA: ***Z. Preteni për fund cili do të ishte mesazhi juaj drejtuar qytetarëve të vendit, në lidhje me korrupsionin dhe luftën ndaj tij?***

Hasan Preteni: Për fund ju bëjë thirrje të gjithë qytetarëve të Kosovës që t'i raportojnë të gjitha rastet për dyshime korruptive sepse korrupsioni ndikon në pengimin e zhvillimit ekonomik dhe rritjen e varfërisë dhe pabarazisë sociale. ■





Plot një muaj fushatë kundër trafikimit të njerëzve



Fatos SHALA

Ka filluar edhe zyrtarisht fushata njëmujore kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Edhe pse Departamenti Amerikan i Shtetit, në raportin e fundit kundër trafikimit të qenieve njerëzore, e ka renditur Republikën e Kosovës në kategorinë e dytë së bashku me shumë shtete anëtare të Bashkimit Evropian dhe NATO-s, Qeveria dhe Ministria e Punëve të Brendshme është duke punuar me kapacitet të plotë që të dalë edhe më pastër nga kjo dukuri. Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Hashim Thaci, në hapjen e fushatës kundër trafikimit të qenieve njerëzore ka deklaruar se strategjia dhe plani i veprimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore, ka qenë dhe do të mbetet ndër dokumentet e para të miratuara nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës. "Qeveria do ta përkrahë vazhdimisht këtë projekt dhe jam i bindur se masat që do të ndërmerren, do të bëjnë eliminimin e kësaj dukurie" - ka thënë kryeministri Thaçi

Ndërkaq, Fatmir Xhelili, zëvendësministër i Punëve të Brendshme dhe koordinator nacional kundër trafikimit të qenieve njerëzore, tha se ky muaj është shpallur muaji kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe në kuadër të kësaj janë përfshirë shumë aktivitete që do të realizohen me të gjitha institucionet e përfshira në Grupin Ndërministror, si vendor ashtu edhe ndërkombëtar.

Qëllimi i fushatës

Kjo fushatë ka si qëllim sensibilizimin e opinionit për punën që po bën qeveria dhe institucionet e saj në drejtim të luftimit të kësaj dukurie. Po ashtu, prioritet i MPB-së është luftimi dhe parandalimi i luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Në raportin vjetor të progresit të Komisionit Evropian është kërkuar që të gjitha shtetet e Ballkanit t'i përkushtohen luftimit të kësaj dukurie, andaj edhe qeveria e Kosovës ka ndërmarrë hapa adekuatë rreth përgatitjes dhe avancimit të institucioneve tona, që të jenë më të afta dhe më të përkushtuara në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Masat e ndërmarra nga Policia e Kosovës

Mirëpo edhe përkundër iniciativës së qeverisë së Kosovës për këtë fushatë njëmujore, të dhënat e Policisë së Kosovës tregojnë një gjendje mjaft shqetësuese në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore.

Në bazë të të dhënave të Policisë së Kosovës janë identifikuar dhe analizuar gjithsej 16 raste vëzhgimi, 7 operacione të fshehura, 21 raste të operacioneve me njësitë e tjera policore dhe 4 raste të operacioneve me inspektorët komunalë. Pas kësaj janë mbyllur 18 lokale, ku supozohet se është ushtruar prostitucion dhe janë arrestuar 24 persona, prej të cilave 14 janë kosovarë, 5 ukrainase, 3 bullgare, një nga Shqipëria, 1 moldave dhe një nga Serbia (shqiptare). Janë identifikuar 6 viktima, prej të cilave 4 janë kosovare, 1 moldave dhe një shtetase e Shqipërisë.

Nga organet e hetuesisë janë duke u trajtuar 10 raste. ■

Çka thotë ligji?

Sipas Rregullores nr. 2001/4 të UNMIK-ut, për ndalimin e trafikimit të njerëzve në Kosovë, çdo person që merret ose tenton të merret me trafikimin e njerëzve kryen vepër penale dhe, pas shpalljes fajtor, dënohet nga dy deri në dymbëdhjetë vjet burg. Në rast se viktima e trafikimit është nën moshën 18 vjeçare, dënimi maksimal për personin që merret me trafikim është deri në 15 vjet burg. Çdo person, që organizon ndonjë grup personash me qëllim që të kryejë veprat e përmendura, pas shpalljes fajtor, dënohet nga pesë deri në njëzet vjet burg.

Roli i edukatës fetare

Emine A. VEZAJ

Ka kohë që parashtroj një pyetje, por nuk më ngushëllon asnjë përgjigje: pse gjatë këtyre viteve të tranzicionit të Kosovës, me halle dhe telashe të mëdha, qytetarët nuk vetëdijesohen se çfarë e ka prishur rendin në familjet e tyre?!

Mishell de Montej, filozof dhe pedagog i njohur francez i shek. XV i bënte kritikë të ashpër trajtimit të fëmijës në shoqëritë ku sundonte padituria dhe obskurantizmi (te disa besime të mëhershme) fetar. Ai vinte në dukje dobësitë e mëdha në procesin e edukimit dhe kërkonte heqjen nga përdorimi të metodave të dëmshme dhe antinjerëzore.



Meqë kam kontakte me nxënës më të rritur, shpesh më bie të dëgjoj edhe këso revoltimesh: "E urrej shkollën. Mësim, disiplinë! Gjithë kohën i detyruar të bësh diçka të urdhëruar nga të tjerët... Do të doja t'ua vija flakën të gjithave, e bashkë me to edhe disa mësuesve të mi...". Këto mund të jenë vetëm disa nga ofshamat e nxënësve që edukohen në kolegje të ndryshme private në Kosovë, të cilët duket se përjetojnë "diskriminime" karshi homologëve të tyre "publikë", të cilët bëjnë një adoleshencë krejt ndryshe. Pohimi i cituar më sipër e vë gishtin mbi shkollën si "problem". Shohim një nxënës të dëshpëruar. Edhe përkundër dëshirës që i është plotësuar ndjekja e mësimit në një shkollë me famë, ai ndien një boshllëk. A ka të drejtë proteste ky nxënës? Nëse nisemi nga parimi se shkolla është disiplinë në kuptimin që kërkon respekt për hapësirën *(ndërtesën, klasat, bankat)*, për kohën *(orët, pushimet mes orëve)* dhe për autoritetin *(mësuesit, drejtuesit, programin mësimor)*, atëherë në rrethanat e tilla nxënësi nuk është i diskriminuar, por i privilegjuar, ndërsa krahasuar me realitetin, atëherë themi se "ka" arsye për revoltë. Në Kosovë shkollat publike rrethakohen nga probleme me përmasa të mëdha... Një pikëpamje e tillë, de facto, shkollat tona i paraqet si të paafta për të kultivuar liderë dhe vizionarë të së nesërmes. Nuk ka dyshim se investimi më i miri që e çon një popull drejt progresit është ai që bëhet për arsimimin e gjeneratave të reja, si dhe për ndërtimin e një rrjeti arsimor që do jetë i hapur për të gjithë. Që do të thotë: ngritja e institucioneve arsimore në nivelin e duhur që të prodhojë elitat e të nesërmes, pa të cilat një shoqëri nuk do mund të shkojë drejt progresit të vet. Një popull që dëshiron të ketë të ardhme të sigurt, duhet të dijë si ta përdorë drejt të sotmen e vet dhe cili investim i tij i bërë sot mund t'i sjell përfitime të mëdha në të ardhmen.

Të nisemi nga parimi i parë;

1. Respektimi i hapësirës shkollore nga nxënësit: Të gjithë arsimtarët janë në kërkim të nxënësve, të cilët e konsiderojnë shkollën si shtëpinë e tyre të dytë. Viteve të fundit jemi dëshmitarë të një angazhimi të kënaqshëm për ngritjen e cilësisë në arsim, duke filluar nga MASHT-i, organizata të ndryshme, batalione të ndryshme të forcave të KFOR-it dhe na gëzon fakti që edhe Kosova, në një të ardhme të afërt, do të konkurrojë në çdo sferë shkencore me liderët e saj të rinj, të cilët mund të sfidojnë edhe moshatarët e tyre nga shkollat me renome evropiane e botërore. Në anën tjetër ndiejmë keqardhje se shumica e nxënësve, të cilat janë pjesë e këtyre institucioneve publike, nuk e kanë as shqetësimin më të vogël për të qenë më të kujdesshëm ndaj objektit të cilin ata e kanë në dispozicion. Fjala vjen, një pjesë e nxënësve të pandërgjegjshëm, të cilët janë të "prirë" për të qenë skandalozë dhe të padëgjueshëm, fillojnë dhe shkruajnë muret e shkollës, dëmtojnë bankat, keqpërdorin inventarin e shkollës, etj.



2. Koha: Larg kësaj nuk janë as ata tipa, të cilët krahas kësaj, kohën që kanë në dispozicion gjatë orarit të shkollës nuk e racionalizojnë aspak. Fjala vjen, gjatë pesë minutave të pushimit të shkurtër, (kohë që llogaritet pushim për t'u bërë ndërrimi i orëve) nxënësit tanë ikin nga mësimi, qoftë për t'iu shmangur ndonjë profesori të pakëndshëm, qoftë për të ikur nga orët e mërzitshme për të shpëtuar nga notat e dobëta, po pse jo, pak minuta edhe në WC (tualet) për të pirë një cigare "shumë relaksuese".

3. Respektimi i autoritetit të shkollës: Po bëhet gati një vit kur zv. koman-


danti i stacionit policor të Rahovecit, toger Osman Ismajli, shprehu shqetësimin e tij rreth huliganizmit si dukuri, gati e zakonshme, në shkollat e Rahovecit me rrethinë. Sipas tij: "në shkollat e mesme të kësaj komune shfaqen sjellje huligane të personave që nuk janë nxënës të këtyre shkollave... Në këto shkolla kanë ndodhur rrahje dhe janë përdorur mjete të ftohta, kurse stafi arsimor nuk është në nivelin e kryerjes së detyrës për t'i parandaluar këto dukuri." Një gjendje të tillë e ka pohuar edhe drejtori dhe disa nxënës. Në Prizren, shumë OJQ kanë pasur temë diskutimi pikërisht edukimin më efikas për nxënësit në shkollat e mesme.

Fetë në "konflikt":

Bashkësitë fetare në thelb janë "bashkësi të kujtesës". Ato e ruajnë kujtesën kolektive të rëndësishme dhe ekzistojnë në saje të vazhdimësisë së kësaj kujtese (Hervieu – Leger, 1998, 2000). Përvojat dhe ritualet fetare të përbashkëta të grupit e riprodhojnë dhe e përcjellin vazhdimisht te brezat e ardhshëm ndjenjën kolektive për atë se "kush jam?" dhe se "ç'kuptim ka jeta në këtë botë?" Ndërmarrjet fetare mund të gjenerojnë rezonancë të përvojave të shumë individëve, madje edhe duke përthelluar në individin ndjenjën më të fortë të besimit dhe ndjekjen e ndonjë misionari të caktuar. Praktikimi i fesë krijon përvojën fetare të grupit, e cila korrespondon me besimin dhe e forcon atë. Koncepti i fesë për t'i dhënë kuptim jetës së njeriut përbën një nga temat qendrore të sociologjisë së fesë, që nga veprat e mëhershme të Werber'it (1958). Geert'i (1966) thekson se "feja shërben si matricë për formimin e kuptimeve. Ajo jo vetëm që e shpjegon realitetin, por edhe i jep trajtë atij. Shablloni i fesë i "përshtat" përvojat e jetës së përditshme dhe i bënë ato të "kuptimta"; këto kuptime të bazuara në fe i trajtojnë përjetimet dhe i orientojnë veprimet e njeriut. Ashtu si shpesh në të kaluarën, një periudhë skepticizmi është zëvendësuar përsëri nga një periudhë e fortë zelli fetar. Feja është bërë nevojë e rëndësishme humane, që nuk mund të lihet mënjanë ose të mos merret në konsideratë, pavarësisht sa e arsimuar ose e sofistikuar është shoqëria jonë. Disa mund ta mirëpresin këtë epokë të re të besimit fetar, të tjerëve mund t'u vijë keq, por asnjëri nuk mund ta përjashtojë fenë si faktor në problemet kryesore të shekullit tonë. Instinkti fetar është jashtëzakonisht i fuqishëm dhe mund të përdoret për mirë ose për keq.

Në anën tjetër, roli që merr feja në shoqëri dallon sipas marrëdhënieve që ekzistojnë mes feve të caktuara dhe shoqërisë civile. Në Kosovë ritualet dhe simbolet fetare mund të pasqyrojnë vetëm një kohezion të njerëzve dhe bashkësive të tyre fetare.

Periudha e 1967-ës, atëherë kur Shqipëria ishte i vetmi shtet ateist në botë, bëri fole edhe në Kosovë. Të gjitha produktet ose gjeneratat e atyre periudhave instaluan në familjet e tyre, e me theks të veçantë në shoqëri, një rrymë antifetare, e cila kohë pas kohe në qarqe të caktuara ka gjeneruar edhe dhunë. Në një vend ku feja nuk është e ndarë



nga shteti dhe luan një rol me peshë në vendimmarrjen politike, në zbatimin e politikave sociale, në veprimet e policisë dhe të zyrtarëve të tjerë, në planprogramet e shkollave kombëtare dhe në përmbajtjen e masmedias shoqëria ndihet më e sigurt.

Bashkësitë fetare në vendin tonë, liderët fetarë të të dy kampeve: myslimanë dhe katolikë, të cilët për shumë kohë kanë mbajtur të heshtur idenë e futjes së edukatës fetare në shkollat publike, duket se kanë hasur në antagonizëm kësaj radhe edhe mes vete! Fillimisht, Bashkësia Islame e Kosovës si nismëtare e kësaj iniciative nuk ka hasur në kurrfarë mirëkuptimi qoftë me partitë politike në opozitë, qoftë me ekzekutivin e vendin, e aq më pak me MASHT-in. Versioni i prerë (më militant) i Bashkësisë Islame të Kosovës se Edukata Fetare në shkollat publike është një domosdoshmëri e jo një përjashtim, nuk është edhe kërkesë e kampit katolik. Sipas të gjitha gjasave, kjo përqindje mund të këtë rënë pasi bashkësia katolike nuk ka as kuadro, as nxënës që të mund të bëjë një grup për t'u zhvilluar mësimi. Së këndejmi, nëse nuk ndërmerret diçka konkrete në këtë drejtim, kam frikë se feja ashtu siç është burim i kohezionit, mund të shkaktojë edhe konflikt. Kohezioni i fesë, sipas Durkhemit, tregon se uniteti moral i vetë grupit është burim i ndjenjës së forcës fetare të përjetuar nga ithtarët. Feja qëndron mbi bazën e ndarjes. Në shoqëritë ku lojalitetet e tjera janë mbi lidhjet fetare, feja nuk mund të shkaktojë konflikt serioz. Megjithatë, mundësia e fesë për t'i caktuar kufijtë "tanë" kundër kufijve të "atyre" e bënë atë një burim inherent të konfliktit.



Alternativa: Edukata fetare për të gjithë!

Njeriu si krijesa më e përsosur në sipërfaqen e tokës posedon ndjenja dhe emocione. Ai nuk është trup i ngurtë mekanik. Ka më shumë nevojë për edukatë se sa për qëndrim. Emocionet janë të kushtëzuara nga natyra e tij biologjike, ndërsa ndjenjat e tij nga ajo sociale. Binomi i këtyre tregon për unitetin e natyrës biologjike dhe sociale të njeriut. Ndjenjat e njeriut mund të jenë primare dhe sekondare. Primare janë ato ndjenja që janë universale për gjininë njerëzore, ndërsa ndjenjat sekondare janë ato të cilat krijohen në bazë të të mësuarit. Gjiri familjar dhe edukata që kultivohet dhe përcillet në një ambient të tillë është më e përshtatshme për zhvillimin e mëtutjeshëm, qoftë emocional, qoftë kjo për ndonjë edukatë fetare, për ndonjë disiplinë shkencore, mbase edhe për ndonjë sport....

Feja, si program Hyjnor i dedikuar për njeriun, është trajta më e vjetër e vetëdijes shoqërore. Madje, ajo është e vjetër sa shoqëria njerëzore. Feja ndikon aq shumë mbi shoqërinë saqë Victor Cousin-i është shprehur se "gjithçka është formuar rreth fesë, për fenë, me fenë". Por edhe përskaj këtij realiteti, feja është perceptuar në mënyra të ndryshme: disa herë është kuptuar drejt, e disa herë gabim. Sipas atyre që e pranojnë si mënyrë të jetës, feja është një sistem i kësaj dhe botës tjetër i dhënë nga i Madhi Zot. Sipas laikëve, feja është një institucion i nevojshëm, por fushëveprimi i saj nuk është kjo botë, por bota e amshueshme. Shkencëtarët dhe pozitivistët pohojnë se "me zhvillimin e shkencës nevoja për fenë do të humbasë", kurse sipas ithtarëve të ideologjisë komuniste "feja është opium për masat popullore" dhe një "shembull tipik i tëhuajsimit të njeriut në aspektin e vetëdijes".

Fakti që besimi islam është jo vetëm besim religjioz por edhe program jete, iniciativa e Bashkësisë Islame është nisur me vend dhe me synim të caktuar: sukses të garantuar. Suksesin e garantuar myslimanët nuk e shohin askund, por ia dedikojnë programit Hyjnor. Ky program duke vënë rregull për njeriun, krijon mundësi që ai të informohet më shumë për veten dhe qëllimin e ardhjes së tij në sipërfaqen e tokës. Nëse mendojmë se qenka e tepërt ajo që kërkon Bashkësia Islame nga ekzekutivi i vendit, atëherë, kjo kërkesë e ka mbështetjen pikërisht në realitetin që shohin çdo ditë në rrugët e vendit. Megjithëse të gjithë krenohemi ose dëshpërohemi nga cilësimet që na bëjnë të tjerët, ne ndiejmë nevojë të njohim edhe veten. Por njohja nga të tjerët nuk na lehtëson njohjen e vetvetes. Për ta njohur si duhet vetveten, që nga fëmijëria duhen bërë një varg veprimesh, të cilat na mundësojnë për të kuptuar se: 'Kush jam unë'? Meqë secili individ është model në vete, atëherë: 'Kush është ai që krijoi një mori modelesh'? 'Kush ka vendosur që unë të jem pjesë e kësaj bote dhe të jem i tillë'? Pyetje tjetër që kërkon përgjigje të qartë është: 'Pse jam në këtë botë'? 'Çka duhet të bëj'? 'Pse ndodh devijimi'? 'Si duhet t'i tejkalojmë krizat'? Të gjitha këtyre pyetjeve dhe të ngjashmeve si këto, kush mund t'u përgjigjej pos Atij i Cili ka vulosur jetën e këtyre krijesave dhe pos Atij që e ka krijuar njeriun në këtë formë, i ka dhënë arsyen, forcën dhe mundësinë për t'u përballur? Të gjitha këto pyetje e kanë përgjigjen vetëm në platformën e besimit islam, e cila është rruga e sigurt e njeriut për një sukses të garantuar.

Njohja e vetvetes, duke pasur në plan të parë adhurimin e Krijuesit, i jep kuptim të bukur jetës. Jeta e përditshme e individit, duke u zhvilluar në kontakt të vazhdueshëm me Krijuesin, gjithsesi bëhet më kuptimplote, më e lehtë dhe më e bukur. Zemra dhe ndërgjegjja e individit nuk kanë nevojë aspak për "stimulues" të jashtëm (drogë, alkool, duhan) që të pastrohen ose qetësohen, sepse raportet e tilla janë të pastra e të qeta vetëm nga lidhja që kanë me Krijuesin e vet. ■

Kush e futi laicizmin në



Prof. dr. Fadil MALOKU

Çka thotë neni 8 i Kushtetutës së Kosovës?

Nëse i adresohemi një sentence të marrë nga Kushtetuta e Kosovës, si ligji më i lartë i një vendi ose shteti, pra nenit 8, ku thuhet tekstualisht: "Kosova është shtet laik. . . . ", sipas këtij neni, në fakt, vendi është një shtet laik! Por a është kështu dhe çka nënkuptojmë me fjalën laik dhe laicizëm? Paraprakisht, këtë term nuk do të mund ta zbërthenim po qe se nuk i adresohemi kuptimit të tij, para së gjithash, sociologjik/jo juridik, jo politik, jo filozofik dhe jo fetar/, i cili mes të tjerash këtë koncept e përkufizon si tendencë të qëllimshme të shtetit për ta margjinalizuar rolin e fesë në jetën publike të një vendi, ose siç thuhet të "shpëtimit të së drejtës, moralit, politikës, artit prej ndikimit të fesë".

Në shekullin e XIX-të laicizmi ka pasur kuptim të njëjtë me pafesinë, me lëvizjen antifetare e ateiste, mënyrë kjo të kuptuari që vazhdon të jetojë edhe sot. Gokalp, laicizmin e ka cilësuar si një term që nënkupton „jofetaren" madje edhe „antifetaren".

Por, nëse i adresohemi etimologjisë sociologjike, kuptojmë se shprehja laicizëm rrjedh nga fjala greke laos që do të thotë: 'popull, turmë' dhe laikos: 'që i përket popullit, masës, gjë e rëndomtë që pak a shumë nuk ka ndonjë peshë të theksuar për të ndërtuar vendin dhe sidomos shtetin', ngaqë këtë e bëjnë elitat politike, pra njerëzit ose menaxherët e sotëm, si shquhen me logjikën e diskursit globalist.

Në periudhën e dominimit të mesjetës (asaj mesjete që dogji në turrën e druve një gjeni si Xhordano Brunon!?) me këtë koncept, në fakt, nënkuptohej personi ose personat që bënin shërbime fetare nëpër tempuj, pra elitë e thjeshtë që nuk kishte të bënte asgjë me ritet dhe funksionalizimin e jetës fetare.

Si e tillë kjo kastë, në fakt, ishte jashtë orbitës së ndikimit të klerit fetar edhe për faktin se nuk kishte detyrime dhe referenca të tjera përveç atyre që u kishin përshkruar klerikët fetar të asaj kohe.

Cili është mendimi i sociologëve për laicizmin?

Që në fillim duhet thënë se rreth këtij koncepti janë bërë dhe akoma po bëhen debate të shumta. Sociologët, e në veçanti politkologët dhe historianët, kanë zhvilluar debate të tëra rreth asaj se nëse sekularizmi është ndonjë primat i materiales ndaj shpirtërores, apo i pasionit fetar ndaj atij shoqëror në mënyrë që të vihet një kontroll më rigoroz ndaj intolerancës dhe mashtrimeve, me qëllim që progresi dhe uniteti shoqëror të jenë më të sigurt. Por për të kuptuar këtë duhet t'i kthehemi historisë së këtij koncepti. Në realitet të parët që e futën në literaturën angleze fjalën "sekularizëm" ishin "mendimtarët e lirë" të shek. të XIX-të, të cilët kishin telashin e ikjes nga stigmatizimi që u bëhej atyre atëbotë si "ateistë" dhe si "të pafe" nga ana e kishës së krishterë.

Një botëkuptim tjetër, jo edhe gjithaq paragjykues, për mendimin e shumicës së sociologëve të sotëm që merren me laicizmin, është edhe ai që këtë proces të vazhdueshëm të elitave ose kastave klerike, që pretendonin se pushteti i tyre është hyjnor, sepse derivon drejtpërdrejtë nga Krijuesi, përpiqen ta këndvështrojnë edhe si përpjekje të popullit ose masës së gjerë për t'i monopolizuar privilegjet e klerit në njërën anë, ndërsa në anën tjetër, për t'i fuqizuar ato si të drejta legjitime të të gjithëve, pa dallim feje, gjinie, race e përkatësie etnike.

Nëse shikohet nga këndvështrimi



Kushtetutën e Kosovës?

politik, kuptojmë se ky term, ose ky koncept, i adresohet kryesisht ndarjes strikte të pushtetit politik nga ai fetar dhe shfrytëzimi i këtij pushteti politik për t'i pavarësuar institucionet dhe ligjet, si edhe për të garantuar të drejtën e çdo individi me anën e ligjeve për të besuar ose për të mos besuar në Zotin e Madhërishëm. Shikuar me dioptrinë e një besimtari të çfarëdo feje, kuptojmë se individit, qytetarit të cilës do fe, i është lënë të besojë më shumë në ligjet e njeriut (lexo: ligjet e njeriut kundruall ligjit të Krijuesit!!!)

Sipas, kësaj logjike del se më e fuqishme na del përkujdesja e njeriut për njeriun, sesa përkujdesja e Krijuesit për krijesën e vet!!! Pra, shikuar me dioptrinë e sociologjisë së religjionit, ideja ose imperativi kryesor i laicizmit është dobësimi i ndikimeve fetare në ndërtimin e kapaciteteve institucionale



përkundrazi një mekanizëm i mundshëm i frikës dhe ambicieve, balancave dhe ndarjeve. Si i tillë, sekularizmi nuk e ka për imperativ eliminimin e dhunës, por vetëm kontrollimin e saj nga ana e shtetit si ndërmjetës, herë-herë i hiles!

Si qëndron perëndimi me sekularizmin?

Franca, bie fjala si vend i centralizuar ka ofertën sekulare për qytetarët e saj, kurse në Angli, edhe pse ajo është e ndërlidhur me Kishën nacionale, qytetarët e saj janë jo religjiozë, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe pse kanë shtet sekular, qytetarët e saj besojnë dhe janë tejet religjiozë. Siç shihet në këto tri shtete, edhe pse sekularizmi ka pothuajse të njëjtat konotime, karakteri modernist, si edhe ai imagjinar, në secilin nga këto shtete dallon dhe specifikohet me rrethanat, mentalitetin, kulturën dhe bindjet e tyre. Në fakt, perceptimi mbi tolerancën në mes këtyre vendeve ka shprehi dalluese dhe specifikuese

Një shembull tjetër për analizë mund të na shërbejë p. sh. edhe India. India, ka një kushtetutë sekulare, por një traditë të shkëlqyeshme të ndërtimit të marrëdhënieve demokratike nga të gjitha vendet e bllokut të tretë. Por, edhe ky vend nuk ka mundur të mbesë imun ndaj konflikteve fetare e sektare mes indusve dhe grupimeve të tjera minoritare siç janë: muslimanët, të krishterët dhe të "paprekshmit". Ky konstatim dëshmon se shteti sekular nuk është gjithnjë garant i qetësisë religjioze të një vendi, por

Janë identik laicizmi me sekularizmin?

Por, në literaturë dhe në jetën e përditshme do të mund të hasim edhe një term, ose më mirë me thënë një botëkuptim tjetër, po ashtu identik dhe mjaft diskutabil, që shquhet si shekullarizëm (lat. saeculum: kohë, botëror), që ka të bëjë me „atë që është e kësaj bote", pra tokësoren që e përdor institucioni i shtetit (duke mos e përjashtuar edhe argumentin e forcës, e jo forcën e argumentit!) për ta margjinalizuar institucionin e besimit fetar nga jeta e përditshme e qytetarëve të saj.

Duhet theksuar se diskursi i laicizmit më tepër i adresohet botës perëndimore krishtere (sidomos asaj katolike), ku janë të ndara qartazi kisha dhe shteti, gjersa botëkuptimi i shekullarizmit i adresohet po ashtu botës krishtere, por asaj protestane.

Por, nëse konkludojmë që sipas shumicës së sociologëve të sotëm perëndimorë laicizmi na qenka rezultat i padrejtësive dhe tendencës së eksploatimit të elitave kishtare në kurriz të shoqërisë, pra masave të gjëra popullore dhe pasojë e një kursi të themi pak a shumë diktatorial të kishës, e cila e përkrahte injorancën dhe e pengonte në emër të kësaj injorance progresin e gjithëmbarshëm shkencor, atëherë shtrohet një pyetje logjike: Si është e mundur të shpallet Kosova shtet laik (!?), kur kisha katolike dhe ajo protestante kosovare ka luajtur jo rol regresiv, siç aludohet nga këta sociologë të shoqërive perëndimore, por të kundërt, duke ndihmuar ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar, në stimulimin e qytetarëve (edhe pse me shumicë absolute islame, një rast unik në botë?!) për ta ndërtuar po këtë shtet që e kemi sot?

Çfarë roli kishin kleri islam dhe ai i krishterë në shtetësinë e Kosovës?

Në anën tjetër, po ashtu kemi rolin shumë pozitiv në favor të identitetit shtetëror dhe të atij kombëtar edhe të BIK-ut (Bashkësisë Islame të Kosovës) që luajti para luftës, me gjitha ato takime të mbajtura nëpër xhamia kundër regjimit diktatorial të Serbisë, me gjithë ata martirë që u flijuan pikërisht për këtë shtetësi që po gëzojmë sot, që nuk është i vogël as për nga numri, e as për nga përkushtimi.

Pra, siç po shihet në rastin e Kosovës, as kleri islam, e as ai i krishterë nuk kishin për qëllim margjinalizimin e po kësaj mase të gjerë popullore për të dre-


jtat e tyre legjitime, e në favor të shtetësisë, që institucionet tash pas luftës me një dekret të pamenduar ad hoc i hodhën nga pjesëmarrja aktive për ta ndërtuar këtë shtet dhe këto institucione!? Ky paradoks i llojit të vet mund të ndodh vetëm në Kosovën si rast sui generis.

Duhet potencuar se tash kurrkush nuk po kërkon që edhe kisha e edhe xhamia duhet të bëhen hisedare në ndërtimin e këtyre kapaciteteve të reja institucionale, që logjikisht duhet të jenë në përputhje me trendet dhe zhvillimet aktuale të kohës. Ama, nuk është e moralshme, e as juridikisht e pranueshme, që ato të privohen nga e drejta e tyre trashëguese për ta ndihmuar shtetin e ri të Kosovës, ashtu siç e ndihmuan edhe para lufte, të bëhen bashkëpjesëmarrëse jo ndoshta edhe gjithaq aktive, por bile të jenë në dijeni për kahet se nga po shkon kjo shoqëri, për të cilën edhe ato kanë kontributet e tyre.

Duhet theksuar, se pa marrë parasysh intencën e njëjtësisë ose theksit për të dalluar diskursin e laicizmit (që ka të bëjë sipas shumicës së sociologëve të sotëm me gjendjen tjetërsuese të kishës dhe të klerit në Evropën mesjetare, pastaj me përplasjet fetare dhe ato sektare, me zhvillimin e filozofisë materialiste asaj pozitiviste dhe asaj pragmatiste, me zëvendësimin e të vërtetës me të dobishmen, me tendencën e përshpejtimit të kalimit nga bashkësia në shoqëri, pra me lindjen e klasave të reja shoqërore, me kalimin nga e drejta tradicionale në të drejtën qytetare, si edhe me zhvillimin marramendës të mendësisë individualiste) nga ai i shekullarizmit, mund të thuhen se të dy këto terma herë pas herë keqkuptohen nga diskursi politik, siç është rasti me Kosovën, e cila me sa duket edhe në këtë sferë është vërtetë një sui generis.

Ka të tjerë sociologë, që laicizmin e perceptojnë ekskluzivisht si pasojë të padrejtësive dhe të tendencës për të monopolizuar dhe për të mbajtur në presion të "hyjnores" shoqëritë perëndimore.

Shikuar me këtë dioptri më të re sociologjike, laicizmi na del si një formë shumë efikase për t'i rregulluar raportet e shtetit me fenë, ku secila e ka rolin e vet: shteti atë të monopolit ekskluziv (!!!) mbi qytetarët e vet (thuajse ai nuk e keqpërdor dhe nuk e devijon kurrë ligjësinë,



të cilën e ka aprovuar vetë me ndihmën e po këtyre qytetarëve (!!!) dhe feja atë të folklorit që i garantohet qytetarit me fuqinë e argumenteve të logjikës së ligjit të krijuar nga elitat dhe magnatët e mëdhenj transnacional.

A janë në krizë shoqëritë laiciste?

Përvoja e këtyre shekujve ka dëshmuar dhe gjithnjë është duke dëshmuar se tendenca laiciste e shoqërive perëndimore është në një krizë të thellë jo materiale, por para së gjithash morale, ngase ajo akoma nuk arriti të sigurojë liri të plotë të ndërgjegjësimit dhe të besimit në kuadër të korpusit të të drejtave të individit, ashtu siç po predikon neoliberalizmi i sotëm.

Pra, laicizmi i sotëm në fakt pretendon të bëhet një lloj rregullatori balancues mes asaj që është shpirtërore (padyshim hyjnores) dhe asaj materiale, mes asaj që është fetare dhe asaj shtetërore, mes asaj që është njerëzore dhe asaj hyjnore, pra me një rekomandim të vetëm: sa më larg që të jetë feja nga individi, aq më mirë do ta ketë shteti dhe elitat transnacionale.



Ky lloj sadizmi i elitave të sotme shtetërore për ta margjinalizuar tërësisht fenë nga jeta shoqëroro-politike, sidomos prezent në shumicën e vendeve që gjenden në procesin e tranzicionit, e që nuk kishin ndonjë përvojë të shtetësisë (rasti ynë është rasti më i mirë për ta ilustruar këtë), në fakt, përveç që është shumëdimensional për t'u analizuar, ka edhe një qëllim tjetër, që për mendimin tim është shqetësues!

E ai ka të bëjë me futjen e fesë në parantezë, në mënyrë që në një fazë tjetër ta abstragojë nga jeta aktive e shoqërisë, duke e kufizuar atë vetëm në sferën e ngushtë të besimit dhe të adhurimit.

Çka thonë librat hyjnorë?

Që të gjithë librat hyjnorë, duke filluar që nga Tevrati, Zeburi, Ungjilli dhe sidomos Kurani (ajetet për shkatërrimin e popujve mizorë/lexo: laikë!) dëshmojnë që tendencat e margjinalizimit të besimit në njëshmërinë e Krijuesit, nga ana e elitave shtetërore në civilizimet e mëhershme gjithnjë dhe gjithmonë kanë qenë të ndëshkuara vetëm shkaku i devijimeve nga rruga e të Gjithëmëshirshmit.

Në Kosovë, rasti i "meritave" për margjinalizimin e fesë nga jeta shoqëroro – politike duket se akoma nuk është i qartë. Ka mendime, jo edhe gjithaq bindëse, për opinionin e gjerë kosovar se tërë këtë farsë rreth futjes së këtij termi të ri, në një vend dhe në një tokë ku "bukës i thuhet bukë, e ujit ujë" (por edhe Zotit i thuhet Allah i Madhërishëm), ua gatoi Administrata e UNMIK-ut. Naivët, pa dyshim, që besojnë, por të tjerët me shumicë absolute nuk e besojnë këtë. . . ! Koha do ta dëshmojë sa jemi shoqëri laike, ngaqë të jesh shoqëri laike, assesi nuk do të thotë që do ta kesh më lehtë të bëhesh evropian ose perëndimor. E kundërta është e vërtetë. Këtë po e dëshmojnë edhe përvojat e gjertanishme nga vetë perëndimorët!■

Autori është sociolog i globalizmit.

Triumfi delirant i marshimit ateist

Mimoza SINANI

Po japim paralelisht dy informacione, që në pamje të parë duket se nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin dhe më pas, do të shqyrtojmë lidhjet korelative ndërmjet tyre.

"Viti i Darvinit"

1. Viti 2009 u cilësua si "Viti i Darvinit", pasi këtë vit ishte 200-vjetori i lindjes së tij dhe 150-vjetori i botimit të librit të tij famëkeq "Mbi origjinën e llojeve". Ky vit u festua në të gjithë botën, nëpërmjet simpoziumeve, botimeve dhe ekspozitave të ndryshme.

Darvinizmi është në fakt një dogmë joshkencore, e cila portretizoi si fakte shkencore ide të tilla të mbrapshta si "njeriu është një kafshë e zhvilluar", "disa raca kanë mbetur prapa gjatë procesit evolucionar" dhe "në natyrë ekziston një luftë për vdekje për të mbijetuar, në të cilën të fuqishmit dalin fitimtarë dhe të dobëtit zhduken".

Zbulimet shkencore do të zbulonin më vonë se këto pohime ishin krejtësisht false. Edhe pse biologjia moderne ka shpjeguar se qeniet e gjalla nuk janë rezultat i rastit dhe ligjeve natyrore, por se janë krijuar nga një Qenie Inteligjente, megjithatë teoria e evolucionit vazhdon t'u mësohet fëmijëve tanë në shkollat shtetërore.

Në Shqipëri, marshimi ateist gjatë 50 vjetëve të shkuara, nën ethet e triumfit delirant, shkeli mbi shkrumbin e tempujve, kishave e xhamive. Gjatë asaj periudhe, ateizmi i kishte monopolizuar të gjithë frerët drejtues shoqëroro-shtetëror, e kishte ngulfatur fenë dhe e kishte e riformuluar shkencën dhe filozofinë sipas ideologjisë së ateiste.

Kjo ideologji e helmuar endet akoma nëpër labirintet e historisë. Qelizat e saj kancerogjene qarkullojnë nëpër venat e njerëzimit duke i shtrirë metastazat e kancerit darvinist.

Rehabilitimi i diktaturës staliniste

2. Para një muaji, duke folur në Institutin Shtetëror të Moskës për Relacione Ndërkombëtare, ministri i jashtëm rus Sergei Lavrov ka thënë se: "Nuk duhen ngritur paralele mes regjimit nazist dhe diktaturës staliniste."

Pra, vihet re se kohët e fundit në Rusi janë shfaqur tendenca, sidomos nga klasa intelektuale, për një zbutje të qëndrimeve ndaj Stalinit, që është figura më monstruoze e kriminalitetit njerëzor. Tendenca të njëjta janë shfaqur edhe në Shqipëri. Herë pas here elementë, nga elita sunduese intelektuale, flasin për një rivlerësim të figurës së Enver Hoxhës. Pra, vihet re mungesa e imunizimit të shoqërive të sotme ndaj utopive dhe ideologjive totalitariste. Prandaj, mjaft

Nuk do të ketë paqe në tokë për aq kohë sa darvinizmi social do të vazhdojë të ekzistojë. Kur njerëzimi të shkundet nga magjepsja e darvinizmit dhe e filozofisë materialiste, ai do të arrijë ta njohë krijuesin e tij, Zotin dhe do të jetojë sipas moralshmërisë që ia ka mësuar Ai

autorë vazhdojnë t'u bien kambanave të alarmit për të na ndërgjegjësuar se shoqëritë e sotme nuk janë aspak të imunizuara ndaj rikthimit të shekullit më të errët të historisë njerëzore, ose "shekullit të mega-vdekjeve".

Pas perdeve të luftërave botërore fshihej figura e errët e Darvinit

Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore, që të marra së bashku rezultuan në humbjen e një totali prej 65 milionë jetë njerëzish, ishte produkt i udhëheqësve evropianë që i shprehnin hapur pikëpamjet e tyre darviniste dhe që kishin besim të fuqishëm te darvinizmi social. Një numër i madh evropianësh i mirëpritën luftërat botërore. Sistemet arsimore të pjesës më të madhe të vendeve evropiane, kishin kaluar nëpërmjet mendësisë konkurruese shoqërore darviniste, në të cilën lufta shihej si gjallërim dhe lartësim. Udhëheqësit evropianë të asaj kohe ishin të influencuar nga darvinizmi shoqëror dhe lufta sipas tyre ishte për të spastruar, nxitur, ripërtërirë.



Ateizmi

Ata e kishin mohuar moralin hyjnor, duke favorizuar në vend të tij darvinizmin shoqëror, që s'ishte gjë tjetër veçse aplikim i teorisë evolucionare të Darvinit në shoqëri.

Ideologjia gjakatare fashiste, që është përgjegjëse për një nga barabarizmat më të mëdha të kohës sonë, është e lidhur me teorinë evolucioniste të Darvinit, e cila ka formuar bazat e ideologjive të ndryshme agresive në gjithë botën, nga shekulli i 19-të deri në ditët e sotme... Vlera e vetme që fashizmi e mbante për të shenjtë është fuqia. I fuqishmi kishte të drejtë të ngrihej në majë dhe ta shtypte të dobëtin. Kjo ideologji u përhap me

shpejtësi në Gjermani, Itali, në Spanjë dhe Japoni.

Hitleri kishte adoptuar pikëpamjen e "luftës së racave për të mbijetuar", e cila ishte baza e teorisë darviniste. Sipas Hitlerit, raca ariane e popullit gjerman ishte në majë të shkallës evolucionare dhe ajo kishte të drejtën të sundonte të gjitha racat e tjera.

Biografia e tij Mein Kampf (Lufta ime), që paraqet një adaptim të "luftës për mbijetesë" të Darvinit, u deklarua të ishte teksti i shenjtë në vend të Biblës.

Edhe udhëheqësi fashist italian, Musolini e konsideronte Darvinin si "mendimtarin më të madh të shekullit të 19-të".

Gjithashtu udhëheqësi tjetër fashist, Francisko Franko, i përkrahur nga Hitleri dhe Musolini, instaloi në Spanjë një nga regjimet më represive. Hitleri dhe Musolini e përdorën Spanjën tamam si një laborator testues për armët dhe trupat e tyre. Aeroplanët bombardues gjigantë shfarosën qytetin e Guernikës që ishte braktisur nga Frankoja në mënyrë që nazistët të testonin aeroplanët e tyre. (Piktori i famshëm Pikaso bëri pikturën murale madhore 'Guernika' që gjendet e vendosur në hyrjen e sallës së Këshillit të Sigurimit si një mburojë e idealeve antiluftë.)

Për këta diktatorë që i shihnin njerëzit si kope kafshësh, derdhja e gjakut ishte thjesht një proces biologjik.

Përballë këtij mentaliteti të çoroditur, ekziston moralshmëria e bukur që Zoti na ka shpallur nëpërmjet religjionit.

Sipas vlerave morale të religjionit, ajo që ka rëndësi nuk është "fuqia", por "e vërteta". Detyra e njeriut është që ta mbrojë të dobëtin dhe të jetë i mëshirshëm dhe paqedashës dhe jo jetë mizor dhe i ashpër.

Zoti i krijoi njerëzit, iu dha atyre një shpirt që është unik ndërmjet të gjitha qenieve të tjera të gjalla dhe i urdhëroi ata që të drejtojnë një ekzistencë morale. Kjo mënyrë jetese kërkon dashuri, vëllazëri, mëshirë dhe paqe. Vetëm nëse njerëzit i binden këtij udhëzimi, bota mund të bëhet një vend paqeje.

Fashizmi nuk është çrrënjosur plotësisht

Dështimi që pësoi fashizmi në Luftën e Dytë Botërore nuk do të thotë se është çrrënjosur plotësisht nga faqja e dheut.

Pas Luftës së Dytë Botërore, fashizmi filloi të shfaqej sërish në vendet e Botës



Adolf Hitler duke folur para masës në Dortumnd të Gjermanisë

së Tretë: në Amerikën Latine dhe në Afrikë

Junta ushtarake e diktatorit Pinoçeti në Kili, junta ushtarake në Argjentinë dhe regjimet fashiste që morën pushtetin në vende të tilla si: Guatemalë, Salvador, Nikaragua dhe Paraguai, kryen barbarizma të pabesueshme.

Regjime të ngjashme mbetën në pushtet për shumë vjet në vende të tilla afrikane, si: Zaire, Ugandë dhe Afrikën e Jugut.

Është e vërtetë se përfaqësuesit më të shquar të fashizmit ishin larguar nga skena, por paganizmi, darvinizmi, dashuria për dhunën dhe racizmi, që ishin themelet e fashizmit, megjithatë mbetën.

Si pasojë e kësaj, në Evropë dhe veçanërisht në Gjermani, filluan të shfaqen partitë neo-naziste.

Në vitin 1970, u shfaq një lëvizje e tmerrshme që u quajt "lëvizje skinhedsash" (ose e shqipëruar "lëvizje kokërruarish") që përbëhej nga të rinj, të moshës 13-25 vjeçare, që kishin nostalgji për nazizmin. Neo-nazistët numërohen deri në 70.000 dhe janë aktivë në 33 vende dhe në gjashtë kontinente. Ata mund të njihen menjëherë nga simbolet naziste në rrobat e tyre, kokat e tyre të rruara dhe tatuazhet.

Ata e lavdërojnë Hitlerin në parulla dhe pohojnë se i janë dedikuar bërjes së ëndrrave të tij një realitet: Një botë e sunduar nga raca ariane.

Ndokush mund t'i përshkruajë ata si "tehu" i sëpatës fashiste. Por kjo sëpatë ka një bisht dhe këta njerëz paraqesin një spektër shoqëror dhe politik më të gjerë sesa neo-nazistët.

Sa herë që përmenden "organizatat fashiste", pjesa më e madhe e njerëzve mendojnë për neo-nazistët gjermanë. Megjithatë, fakti është se ekzistojnë shumë më tepër grupe nën ombrellën fashiste. Në SHBA ekzistojnë shumë grupe aktive fashiste dhe në "nivelin teorik" ato janë në një pozicion më të rëndësishëm sesa neo-nazistët gjermanë. Këto grupe përdorin përgjithësisht sloganin "Supremacia e Bardhë".

Organizatat e ndryshme fashiste, të tilla si Ku-kluks-klani, Partia Naziste Amerikane, Lëvizja e Kombit Arian dhe Aleanca Nacionale gjenden nën ombrellën e Supremacisë së Bardhë.

Qëllimi i këtyre grupeve, të cilët janë aktivë në internet, është që të propagandojnë doktrinën e një botëkuptimi racist dhe që ta përhapin atë sa më shumë që të jetë e mundur.

Racizmi fashist, i lindur nga rizgjimi i kulturës pagane në shekullin e 19-të dhe nga teoria e evolucionit e Darvinit, është ende duke u rritur në shekullin e 21-të dhe mbështetet saktësisht mbi të njëjtat themele.

Komunizmi e shndërroi botën në një thertore

Edhe komunizmi, ndonëse u shfaq i rrethuar nga parullat e bukura rreth drejtësisë dhe barazisë, në të vërtetë nuk i solli njerëzimit asgjë tjetër përveçse gjak dhe vdekje. Ideologët dhe diktatorët komunistë janë përgjegjës për vdekjen e 50 milionë njerëzve. Komunizmi vërtet e shndërroi botën në një thertore. Duke e marrë teorinë e evolucionit si bazën e

vet të ashtuquajtur shkencore, ideologjia komuniste u përhap me shpejtësi, duke qenë dëshmitare e revolucionit të saj të parë në Rusi. Pas marrjes së pushtetit, Lenini vendosi një diktaturë dhe ushtroi terror anembanë Rusisë.

Ai nuk kishte as ndjenjën më të vogël të mëshirës për armiqtë e tij dhe torturoi deri në vdekje ose pushkatoi dhjetëra mijëra kundërshtarë të regjimit. Megjithatë, faqet më të përgjakshme të kësaj historie të përgjakur, u shkruan nga një diktator tjetër, një njeri që e la madje Leninin nën hije. Ky diktator ishte Stalini, një prej vrasësve më të këqij të historisë. Stalini, ndonëse ishte arsimuar si prift gjatë rinisë së tij, u bë ateist pas leximit të librit "Origjina e Llojeve" të Darvinit.

Komunizmi ishte në kuptimin e mirëfilltë një "sundim i terrorit". Stalini do të duartrokitej për minuta të tëra në fund të kongreseve të partisë komuniste për arsye sepse çdokush tmerrohej që të ishte i pari që do të ndalonte.

Ideologu që ka pjesën e vet të kësaj përgjegjësie, është Çarls Darvini.

Komunistët, të cilët bënë revolucione të përgjakshme dhe kryen masakra të pamëshirshme ishin duke vënë në jetë teorinë e Darvinit.

Një komunist tjetër famëkeq, që drejtoi rrjedhën e ndryshimit në Kinë, ishte Mao Ce Duni. Flamuri i Partisë Komuniste që u ngrit mbi muret e Pekinit përfaqësonte periudhën më të errët për popullin e Kinës. Turmat e mbledhura nën flamujt e kuq në Sheshin Tiananmen duartrokisnin komunizmin. Por pjesa më e madhe e atyre që aq gëzueshëm e brohoritën Maon së shpejti do të bëheshin viktimat e mizorisë së tij. Kur Maoja thoshte se: "Baza e socializmit kinez mbështetet mbi Darvinin dhe teorinë e tij të evolucionit," ai, në të vërtetë, sqaronte bazën e barbarizmit që ai kreu. Ky ishte një rrjedhim natyror i darvinizmit që ai kishte përvetësuar në rininë e tij.

Në vitin 1960, kur marrëdhëniet kino-sovjetike u prishën, maoizmi gjeti përkrahje në Shqipëri, në Korenë e Veriut dhe në Kamboxhia, regjimet e të cilave shkaktuan vuajtje pothuaj të paimagjinueshme mbi njerëzit.

Guerilët komunistë kamboxhianë, të njohur si Kmerët e Kuq, të udhëhequr nga maoisti i quajtur Pol Pot, kryen një terror të lemerishëm.

Kjo është ajo që komunizmi dhe filozofia materialiste i solli njerëzimit.

Po ashtu, në Kubë sundonte regjimi komunist i Fidel Kastros.

Udhëheqësi komunist gueril Çe Guevara u përpoq që të organizonte luftë guerile në Kongo dhe Bolivi. Shumë shtete të tjera në Afrikë, në Amerikën Latine dhe në Azi ishin nën kërcënimin e organizatave terroriste komuniste ose regjimeve komuniste.

Ideologjia marksiste u përhap me shpejtësi edhe ndërmjet të rinjve në Perëndim. Mendimtari marksist Herbert Markus luajti një rol të rëndësishëm në këtë fenomen. Besimi i Markusit te dogma darviniste se konflikti ishte ligji themelor i natyrës e nxori gjeneratën e viteve '68 në rrugë. Të rinjtë në Britani, në Francë dhe në Itali organizuan mitingje protestash, në të cilat ata brohoritnin slogane socialiste.



Njerëzimi do të mund të çlirohet nga komunizmi dhe ideologjitë e tjera të përgjakshme vetëm kur të eliminohet mashtrimi darvinian.

Kur njerëzimi të shkundet nga magjepsja e darvinizmit dhe e filozofisë materialiste, ai do të arrijë ta njohë krijuesin e tij, Zotin dhe do të jetojë sipas moralshmërisë që ia ka mësuar Ai.

Nuk do të ketë paqe në tokë për aq kohë sa darvinizmi social do të vazhdojë të ekzistojë. Kjo ideologji i fton kombet dhe madje të tërë civilizimet në konflikt të vazhdueshëm. Sipas darvinizmit social, kjo është arsyeja për ekzistencën e njerëzimit.

E vërteta, nga ana tjetër, është krejt ndryshe. Njerëzit nuk ekzistojnë për të luftuar me njëri-tjetrin, por për ta adhuruar Zotin dhe për t'i drejtuar jetët e tyre sipas udhëheqjes së Tij. Kjo kërkon dashuri, falje dhe paqe. Kur njerëzit ta kuptojnë këtë, atëherë do të marrin fund luftërat dhe lotët dhe do të mbisundojë paqja dhe lumturia.

Vlerat fetare sigurojnë përsosjen moraleve të shoqërisë

Ideologjia komuniste është rezultat i një botëkuptimi që e konsideron njeriun si një specie të kafshëve dhe beson se ai përparon nëpërmjet konfliktit. Fakti se regjimet komuniste në Bashkimin Sovjetik dhe Bllokun Lindor u rrëzuan nuk duhet të na lejojë që ta humbasim vigjilencën. Komunizmi është ende një kërcënim për botën, sepse filozofia bazë e ideologjisë është ende gjallë. Për sa kohë që kjo bazë, pra me fjalë të tjera darvinizmi dhe materializmi është ende gjallë, komunizmi do të vazhdojë të paraqesë një rrezik të rëndë për njerëzimin.

Vetëm vlerat e fesë sigurojnë përsosjen e moralit të shoqërive dhe individëve. Rrugëzgjidhja për ndalimin e konflikteve, dhunës dhe pabarazisë ekonomike nuk gjendet te ndalimi i fesë, por krejt e kundërta: ajo duhet kërkuar te përpjekjet për përhapjen e virtyteve fetare.

Njerëzimi nuk duhet të ketë kurrë frikë nga feja, por nga mungesa e saj. Morali fetar i sjell shoqërisë paqe, mirëqenie, drejtësi dhe tolerancë. Në një shoqëri ku ndjenja e fesë është e fortë, nuk mund të ketë dhunë, degjenerim ose frikë. Inkorporimi i fesë hyjnore në sistemin arsimor është i domosdoshëm sepse feja e vërtetë ndërton ura ndërlidhëse ndërmjet njerëzve dhe popujve, ndërsa pseudofetë i rrënojnë ato. Lënda fetare është pjesë përbërëse e planprogramit mësimor në shkollat shtetërore, të dyzet shteteve të Evropës, midis të cilave në Austri, Gjermani, Angli, Spanjë, Belgjikë, Greqi, Irlandë, Finlandë, Danimarkë, Norvegji, Suedi, Hungari, Poloni, Itali, Lituani, Slloveni, Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë, etj. dhe urojmë që së shpejti ajo të bëhet pjesë përbërëse e planprogramit mësimor edhe në shkollat tona, këtu në Kosovë. ■

Shefi negociator i Turqisë për integrime evropiane, Egemen Bagis, i bëri thirrje Brukselit për m

Evropa ka më shumë nevoj



Egemen Bagis që nga fillimi i këtij viti është shef i negociatave të Turqisë me BE-në. 39 vjeçari, në vitin 2002 hyri në parlament me partinë në qeveri AKP. Ai, ndër të tjera, ishte edhe drejtues i komisionit nënparlamentar për marrëdhëniet Turqi-SHBA.

"WIENER ZEITUNG": ***Në fillim të këtij viti gazetat kishin shkruar për 2008-ën si 'viti i humbjeve' në lidhje me negociatat e Turqisë dhe BE-së për integrim. Çka do të na tregoni për 2009-ën?***

Egemen Bagis: "Uue, me çfarë tempi ke filluar!" Ne e kishim një fillim të definuar. Më 1 janar ne e dorëzuam platformën tonë të reformave për katër vitet e ardhshme. Një javë më pas, kryeministri Erdogan caktoi shefin e negociatave për BE-në. Pastaj Erdogani menjëherë, për herë të parë pas katër viteve, udhëtoi për në Bruksel. Gjithashtu filloi edhe transmetimi i televizionit kurd TRT 6 në gjuhën kurde, ndërsa para dhjetë viteve njerëzit kishin frikë të pranonin identitetin e tyre se ishin kurdë. Përveç kësaj, ne e kemi harmonizuar ligjin e doganave me standardet e BE-së dhe, me këtë, kemi hapur një kapitull të ri sa u përket tatimeve. Në anën tjetër, jemi në kërkim të dialogut me minoritetet religjioze. Por, megjithëkëtë, kritikat ndaj Turqisë, se ajo po bën shumë pak, nuk kanë ndryshuar, ndoshta sepse kritikët nuk po mund ta ndjekin ritmin e punës sonë.

"WIENER ZEITUNG": ***Ku po mbetet atëherë përparimi në çështjen e Qipros?***

Bagis: Turqia ka marrë për obligim t'i hapë portet e saj detare për anijet e Qipros. Në anën tjetër edhe BE-ja do të duhej t'i jepte fund izolimit të Qipros Veriore; dhe pyes a e ka mbajtur premtimin vet?


Egeman Bagis

"WIENER ZEITUNG": ***A do të thotë kjo se nëse ajo nuk e zbaton, atëherë as Turqia nuk do t'i përmbushë kushtet e veta?***

Bagis: Të dyja palët duhet t'i përmbushin kushtet njëkohësisht. Nuk është e drejtë që grekët qipriotë të mund të blejnë djathë prej turqve qipriotë, kurse austriakët jo. Kjo ndodh sepse nuk ekziston një tregti e drejtpërdrejtë me Qipron Veriore. Ne jemi të gatshëm t'i përmbahemi pjesës sonë të marrëveshjes, por edhe BE-ja duhet ta bëjë të njëjtën gjë. Askush nuk duhet të pres diç tjetër prej Turqisë vetëm pse ajo dëshiron të bëhet anëtare e BE-së, sepse kjo nuk ia vlen. Ne kemi pritur 50 vjet për integrimin në BE dhe mund të presim edhe 50 vjet të tjera.

"WIENER ZEITUNG": ***A e dëshiron Turqia këtë gjë?***

Bagis: A ka llogari Evropa të na mbajë kaq gjatë në listën e pritjes? Ne kemi nënshkruar një marrëveshje për gazsjellësin Nabuko-Pipelin që është një hap i mirë për zbutjen e krizës energjetike. Por ne nuk po mund ta hapim kapitullin e energjisë, për të vetmen arsye se një ishull i vogël kundërshton. Si mundet atëherë BE-ja të na shtyjë neve drejt më shumë reformave, kur ne jemi duke e ndihmuar atë në zgjidhjen e problemeve të saj dhe, në të njëjtën kohë, pengohemi nga po e njëjta që të bëjmë më shumë? Evropa ka më shumë nevojë për Turqinë sesa e kundërta.

"WIENER ZEITUNG": ***Atëherë edhe Turqia mund të heqë dorë nga BE-ja. A mund ta paramendoni një gjë të tillë?***

Bagis: Ekzistojnë tre skenarë. Ne do t'i përfundojmë negociatat dhe ose do të bëhe-

ë shumë fleksibilitet

jë për neve sesa e kundërta

mi, sikurse Malta ose Bullgaria, anëtare e BE-së, ose disa shtete do të mund të na nxjerrin probleme si Franca Britanisë. Mundësia e tretë është si shembulli i Norvegjisë që, pas përfundimit të bisedimeve, turqit t'i thonë Bashkimit Evropian: jo, falemind-erit.

"WIENER ZEITUNG": ***Edhe sot shumë njerëz (në Turqi) mendojnë kështu. Ata e ndiejnë veten të padëshiruar në BE?***

Bagis: BE-ja nuk e ka të drejtën të na refuzojë. Ajo na ka lënë të presim për 50 vite me radhë dhe tani është shumë vonë për të ndryshuar mendimin (për mospranimin tonë). Gjithashtu, BE-ja nuk mund t'i zgjidhë vetë problemet për sigurimin me energji, për luftën kundër terrorizmit ose imigrimin ilegal - pa Ankaranë. Ne jemi e gjashta në Evropë për nga fuqia ekonomike dhe e katërta për nga fuqia punëtore, kurse mosha mesatare këtu te ne është 28 vjet.

"WIENER ZEITUNG": ***Kjo është ajo prej të cilës kanë frikë shumë evropianë: fakti se këta njerëz do të mund të kërkojnë punë në Evropë.***

Bagis: Po pikërisht për këtë gjë Evropa ka nevojë. Në njëzet vitet e ardhshme ajo nuk do të ketë fuqi të mjaftueshme punëtore.

"WIENER ZEITUNG": ***Edhe vetë Turqia përfiton në përafrimin me BE-në. A nuk e deklaron vetë qeveria se ajo dëshiron të forcojë demokracinë e të ngrejë standardin e jetesës?***

Bagis: Kur ne erdhëm në pushtet, në vitin 2002, të ardhurat për kokë banori ishin 3300 dollarë amerikanë, e sot janë 10.000 dollarë. Shuma e investimeve të huaja ishte një miliard dollar për çdo vit, kurse mesatarja e gjashtë viteve të fundit është 20 miliardë.

"WIENER ZEITUNG": ***Pjesa lindore e vendit nuk i ka as këto të hyra për kokë banori dhe as investimet e jashtme. Çka është duke bërë qeveria që të ngushtojë dallimet mes pjesës perëndimore dhe asaj lindore të vendit?***

Bagis: Për këtë duhet kohë. Por ne kemi filluar që atje, në fshatra, të ndërtojmë rrugë, shkolla dhe spitale dhe një e treta e shkollave dhe e shtretërve në spitale janë vënë në dispozicion në këto shtatë vitet e fundit, kurse për këtë vit ne kemi ndarë 500 milionë euro për zhvillim.

Intervistoi:
Martyna Czarnowska
nga Ankaraja
Përktheu dhe përshtati:
Avni Xhemajli





Muhamed J. KAJOLLI

Vepra dhe shkaqe

Marrëveshja ishte që Abdullah bin Sead bin Serrah të shkarkohej dhe në vend të tij të emërohej Muhamed bin Ebi Bekër. Por ajo që e acaroi situatën edhe më shumë, pas kësaj marrëveshje, ishte letra postale e cila doli nga rezidenca e Osmanit r.a., në duart e djalit të tij, i cili kishte hipur në devenë e tij

Ia vlen të përkujtohet që në fillim të kësaj teme duaja e Omerit r.a. për t'u transferuar në botën tjetër, për shkak të moshës së tij, ndonëse ai ishte më i ri në moshë se Osmani r.a. Ai frikësohej se nuk do të ishte më në gjendje ta kontrollonte administratën e formuar prej tij, sepse shteti tanimë ishte shtuar për disa milionë km2. Ndërsa Osmani nuk e kishte ndier këtë nevojë dhe kishte pranuar të ishte njëri prej gjashtë kandidatëve për kalif.

Osmani r.a. nuk i ngjasonte Omerit r.a.

Kur Osmani r.a. u betua se do ta pasonte rrugën e dy kalifëve para tij, ai nuk mendonte ndryshe. Askush nga sahabët nuk mendonte se Osmani r.a. kishte ndonjë mendim ndryshe nga ai që tha, kuptohet në parimet bazë. Në të vërtetë, askush nuk mund të pasonte rrugën e tjetrit sepse, ai, nuk mbetej më vetvetja. Secili njeri ka tiparet dhe karakteristikat e veta dhe në këtë rast themi se Osmani r.a. nuk kishte dyshim në veprat e paraardhësve të tij dhe për këtë arsye kishte deklaruar se do të pasonte rrugës së shokëve të tij të ngushtë.

Megjithatë ai ndryshoi disa prej rregulloreve të Omerit r.a. Siç kishim theksuar më herët, Omeri e mori drejtimin e shtetit islam nga Ebu Bekri r.a. i cili kishte përgatitur terrenin për përhapjen e fesë jashtë trojeve të tokave arabe. Shteti islam po zgjerohej dita-ditës në kohën e tij, mirëpo ky njeri kishte një nuhatje të veçantë politike, ishte strateg dhe shumë i kujdesshëm. Ai nuk nxitonte shumë dhe nuk ishte i etur për toka të reja. Ai fillimisht duhej të bindej se gjendja e tokave të çliruara ishte stabile dhe çdo gjë shkonte sipas parashikimeve dhe strategjisë së tij. Kështu kishte urdhëruar Amër bin Asin që të mos nxitonte e të marshonte për në Egjipt, pa e qetësuar mirë gjendjen në Palestinë. Ndërsa Osmani r.a. nuk e kishte këtë nuhatje. Ky në karakter ishte shumë i butë dhe kjo cilësi, e bënte të mos i refuzonte ambiciet e mëkëmbësve (prefektëve) të shtetit. Kështu Muaviu nuk e përfillte aq shumë që të merrte leje për ndonjë platformë politike ose ushtarake.

Një karakteristikë tjetër e Omerit r.a. ishte se ai kishte ndjeshmëri ndaj njerëzve në përgjithësi. Duke qenë se ishte ngarkuar me detyrën e të parit të muslimanëve, ai ndiente përgjegjësi për secilin besimtar. Ai kishte nuhatur se kurejshitët po i gëzoheshin pa masë fitoreve të ushtrisë myslimane. Ata e shihnin veten se së shpejti do të pasuroheshin. Por, këtë ambicie ua shkurtoi Omeri r.a. duke ua ndaluar atyre të dilnin jashtë territorit të Hixhazit. Omeri r.a. mendonte se pasuria e shpejtë mund ta ndryshonte besimtarin e ri dhe kështu të arrihej deri te destabilizimi dhe shkatërrimi i shtetit. Ai i frikohej shpërthimit të brendshëm dhe trazirave të papritura nga klanet e mundshme që mund të krijoheshin prej tyre. Për këtë arsye, ai kishte ndaluar të mos depërtonte zjarri ndër këta besimtarë të varfër.

Por këtë strategji të Omerit r.a., Osmani r.a. sikur nuk e kishte vërejtur dhe me t'u bërë kalif, i lejoi të gjithë muslimanët, duke mos përjashtuar as kurejshitët, të endeshin lirshëm në të gjitha territorin e shtetit islam.

Osmani r.a. ishte një person, i cili ishte paralajmëruar nga Muhamedi s.a.v.s. se i përkiste dhjetë personave që u ishte garantuar xheneti, por kjo nuk e bënte atë sikurse Omeri r.a. Ky paralajmërim nuk do të thoshte se Osmani do të vazhdonte rrugën e Ebu Bekrit dhe Omerit (kënaqësia e Allahut qoftë mbi ta). Omeri r.a. fillimisht sigurohej dhe pastaj merrte qëndrim në vendimet i tij. Pas atij vendimi ai nuk falte askënd, ishte i drejtë dhe njëkohësisht i ashpër. Ndërsa Osmani kishte mangësi në sigurim, pastaj ishte i butë dhe ia linte kohës që ta zgjidhte problemin.

Një karakteristikë tjetër e Omerit r.a. ishte se ai në asnjë mënyrë nuk lejonte që një njeri i familjes së tij të ngrihej lart në detyrë shtetërore, ndërsa Osmani r.a. nuk ishte i tillë. Përkundër drejtësisë së Osmanit dhe padjallëzive të tij, ai ishte i pafuqishëm që t'u thoshte jo pjesëtarëve të familjes, kur ata i kërkonin ndonjë post në ndonjë krahinë. Në kohën kur ishte vendosur të zëvendësohej mëkëmbësi i Basrës (Eba Musa el Esharij), ai dërgoi në vend të tij Abdullah bin Amir bin Kurejz-in, djalin e dajës së tij. Në Kufë zëvendësoi Mugire Ibën Shouben, me Sead Ibën Ebi Vekas-in. Pas një viti shkarkoi Seadin dhe atë e zëvendësoi me Velid bin Ukbe-n, vëllanë nga qumështi, të cilin pas më shumë se një vit e zëvendësoi për shkaqe shumë të arsyeshme[1] me Sead Ibën As-in. Në Egjipt e shkarkoi Amër bin As-in, një prej kushërinjve të tij dhe dërgoi Abdullah bin Sead bin Ebi Serrah[2], vëllanë tij nga nëna.



Kështu qendrat kryesore të shtetit Islam (Egjipt, Sham, Kufe dhe Basra) ishin në duart e familjes As dhe Ebu Sufjanit. Këto dy familje ishin kushërinjtë e Osmanit r.a. Tabariu, një prej përmbledhësve të parë të historisë islame, transmeton se kurejshitët tanimë ishin shpërndarë nëpër të

...et e vrasjes së Osmanit r.a.



gjitha territoret e shtetit islam, vetëm për një vit të sundimit të Osmanit r.a. dhe sipas argumenteve të grumbulluara prej tij, kurejshitët kishin arritur të mblidhnin pasuri të majme dhe t'i formonin klanet e tyre.

Kronologji e shkurtër gjatë sundimit të Osmanit r.a.

- *Më 24 të hixhretit, gjegjësisht më 3 muharrem të vitit 24, Osmani emërohet zyrtarisht kalif i muslimanëve. Po në këtë vit, Osmani r.a. zëvendësoi Mugir Ibën Shoubet-en me Sead Ibën Ebi Vekas-in.*
- *Më 25 të hixhretit, Amër bin As, kërkoi nga Abdullahu bin Sead bin Ebi Serah që të jetë në krye të ekspeditës së gjatë për çlirimin e Afrikës Veriore.*
- *Më 26 të hixhretit, Sead bin Ebi Vekasi u zëvendësua nga Velid bin Ukbeten, i cili kishte komanduar ushtrinë muslimane për në Azerbejxhan. Po në këtë vit u bë zgjerimi i mureve të Qabesë.*
- *Më 27 të hixhretit Osmani lejoi që ushtria muslimane të marshonte drejt Afrikës së Veriut. Po në këtë vit zëvendësoi mëkëmbësin e Egjiptit Amër bin As me Abdullah bin Sead bin Ebi Serah-in.*
- *Më 28 të hixhretit, muslimanët formuan flotën e parë. Marina muslimane e Shamit e drejtuar nga Muaviu dhe ajo e Egjiptit e drejtuar nga Abdullahu sulmuan dhe e çliruan Qipron.*
- *Më 29 të hixhretit, u bë zgjerimi i xhamisë së Pejgamberit në Medinë. Osmani r.a. e shkarkoi Ebu Musa Eshariun nga Basra dhe në vend të tij emëroi Abdullah bin Amir bin Kurejzin.*
- *Më 30 të hixhretit, Seid bin Asi çliroi Taberistanin. Në këtë vit u shkarkua nga detyra Velid bin Ukbete dhe në vend të tij u emërua Seid bin Asi. Po në këtë vit, Osmani e humbet unazën e Pejgamberit s.a.v.s., e cila përdorej si vulë e shtetit.*
- *Më 31 të hixhretit, u zhvillua beteja e quajtur Savarij midis ushtrisë së Muaviut nga ana e muslimanëve dhe Konstandidnit birit të Herakliut nga ana e bizantinëve. Ushtrisë së Muaviut i kishte shkuar në ndihmë marina muslimane e Egjiptit. Beteja përfundoi me fitoren e muslimanëve. Në këtë vit u çlirua, Armenia nën komandën e Habib bin Meslemeh, ndërsa në Persi u vra edhe perandori i fundit Jazdexhird nga personeli i kabinetit të tij.*
- *Më 32 të hixhretit, u zhvilluan beteja të njëpasnjëshme të muslimanëve të drejtuar nga Muaviu me bizantinët, derisa ushtria muslimane arriti në ngushticën e Dardaneleve. Në këtë vit u pushtuan Gilani (në veri të Iranit të sotëm) dhe Gjeorgjia. Po në këtë vit vdiqën: Abasi i biri i Abdul Mutalibit, Abdullah Ibën Mesudi dhe Abdurrahman bin Aufi.*
- *Më 33 të hixhretit, kalifi Osman dha urdhër që të internohej grupi rebel i Kufes për në Sham. Pas një orvatjeje të Muaviut me ta, ky i fundit dha urdhër që të largohej ky grup i papërmirësueshëm, për të shkuar në Hims. Pasi dhanë shenjat e pendimit dhe premtuan se do të përmirësoheshin, grupi rebel u kthye serish në Kufe. Një tjetër ngjarje me rëndësi ndodhi. Osmani u akuzua nga besimtarët dhe shokët e tij të ngushtë për nepotizëm.*
- *Më 34 të hixhretit, kalifi Osman, kërkoi nga mëkëmbësit e qendrave më të mëdha takim konsultimi për grupet rebele. Në takim morën pjesë: 1. Muavije Ibën Sufjani, 2. Amër bin Asi, 3. Abdullah bin Sead bin Ebi Serrah, 4. Sead bin Asi, 5 Abdullah bin Amiri. Po këtë vit u zhvillua një debat konstruktiv midis Aliut dhe Osmanit (kënaqësia e Allahut qoftë mbi ta), për gjetjen e shkakut se si u arrit deri te formimi i çetave rebele. Grupi rebel i Kufes ngadhënjeu, pasi arriti ta rikthejnë Ebu Musa Eshariun të parin e Kufes.*
- *Më 35 hixhri, çetat rebele nisen sërish nga Egjipti, Kufja dhe Basra për në Medinë, kinse për në Haxh. Rebelët e Egjiptit favorizonin Alinë, ata të Basrës Talhan, ndërsa ata të Kufes Zubejrin. Kalifi Osman u vra në moshën tetëdhjetë e një, ose tetëdhjetë e tri vjeçare. Osmani sundoi dhjetë vjet, gjashtë muaj dhe tri ditë.*[3]

Debati midis Alisë dhe Osmanit (kënaqësia e Allahut qoftë mbi ta)

Vakidiju, i cili është bazuar në thëniet e Abdullah bin Muhamed e ky te babai i tij, transmeton se në vitin 34 hixhri besimtarët filluan të bëhen edhe më të zëshëm rreth nepotizmit të Osmanit r.a.. Të gjithë të përzgjedhurit e tij, si Muaviu, Mervani, Abdullah bin Amiri, Abdullah bin Seadi, ishin prej të njëjtës familje... Dhe kështu një ditë kërkuan nga Aliu (Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij) që të bisedonte çiltas me Osmanin r.a.

- *Alia i tha: Nuk mendoj se nuk i di të gjitha akuzat për të cilën më kanë dërguar besimtarët të bisedoj me ty, prandaj nuk di si t'ia filloj. Ti ishe një nga shoqëruesit më të afërt të Pejgamberit s.a.v.s. dhe bashkëshorti i dy bijave të tij. Bamirësitë e tua janë të panumërta... A e di se mbi të gjitha veprat e mira është që imami (prijësi) të jetë i drejtë dhe kjo cilësi, e bën që*


edhe populli të jetë i hareshëm dhe i lumtur... Ndërsa veprat më të këqija, prej nga vijnë edhe të gjitha sherret në umbet, janë rezultat i imamit të lig...Kam dëgjuar Muhamedin s.a.v.s. të ketë thënë: "Imami i lig nuk do të ketë vend në ahiret, e as dhembje, ai do të dërgohet në xhehenem...". Uroj të mos jesh imami i këtij umetit, i cili do të vritet, sepse për të thuhet: Do të vritet nga ummeti një imam, nga i cili do të përhapen përçarjet dhe vëllavrasja deri në Ditën e Kiametit dhe natyrisht që të gjitha veprat e liga do t'i vishen atij..."

- *Osmani iu përgjigj: - 'E dija për çfarë do të bisedoje. Sikur të ishe në vendin tim, nuk do të poshtëroja, e as nuk do të dorëzoja. Ti nuk ke ardhur këtu me qëllim të keq... A e di ti, o Ali, se këtu nuk është Mugire bin Shoube?*
- *- 'Po', - iu përgjigj Alia.*
- *Osmani i tha: -'A e di ti se atë e emëroi Omeri? Atëherë pse po më akuzoni për nepotizëm?'*
- *- 'Po, do të tregoj', - iu përgjigj Alia. - 'Të gjithë ata që emëroheshin nga Omeri vërtet ishin meritorë, por në të njëjtën kohë edhe dënoheshin ashpër prej tij, ndërsa ti nuk po e bën këtë. Po tregohesh i dobët përpara familjarëve të tu'.*
- *Osmani: - 'Ata gjithashtu janë edhe pjesëtarë të familjes tënde, o Ali'.*
- *Aliu: - 'Vërtet mund të thuhet ashtu, por përparësi tek unë nuk kanë këta, por të tjerët'.*
- *Osmani: - 'Sigurisht që ti e di se Omeri e emëroi Muaviun gjatë gjithë mandatit të tij, ndërsa unë vetëm ia vazhdova mandatin atij'.*
- *Alia: - 'A e di ti se Muaviu i frikësohej shumë Omerit, bile më shumë se një fëmijë?'.*
- *Osmani: - 'Po është e vërtetë'.*
- *Aliu: - 'A nuk ta vrasin veshin vendimet e shpeshta të Muaviut pa u konsultuar me ty, ndërsa ti kur i dëgjon, nuk merr masa kundër atyre vendimeve, ose nuk e shkarkon atë?'*

Këtu debati u ndërpre. Aliu doli dhe pas pak doli edhe Osmani, i cili u ngjit drejt mimberit dhe mbajti një ligjëratë në xhami. Ligjërata e tij ishte arsyetim dhe njëherësh ai kërkoi falje nëse dikush mendonte se Osmani kishte pasur ndonjë qëllim të tij personal. Ndërsa akuzën se ai i shpërndante familjarëve të tij nga pasuria e shtetit, ai e demantoi duke iu argumentuar se ajo ishte nga pasuria e tij personale. Pak para përfundimit të fjalimit, u ngrit Mervan bin Hakemi,[4] dhe tha: Po deshët le të gjykojë midis nesh dhe ju shpata."[5]

Falsifikimi i letrës

Osmani r.a., pasi u informua mirë për zbarkimin e çetave rebele në afërsi të Medinës, mblodhi këshillin e vet dhe perfektët e Shamit, Egjiptit, Basrës, Kufës dhe të tjerë. Pasi i dëgjoi të gjitha sugjerimet[6], në fund mori vendim dhe tha: 'Të mos përdoret forca në asnjë mënyrë. Le të gjykojë koha, le të mos bëhemi shkaktarë të vrasjeve midis vëllezërve'.



Numri i çetave rebele, krahasuar me forcën ushtarake të kalifit, as që mund të krahasohej. Ata ishin ndarë në tri grupe dhe secili grup kishte nga katër nëngrupe. Të gjithë së bashku nuk përbënin më shumë se njëmijë e pesëqind rebelë. Por ajo që i bënte të fuqishëm këta rebelë ishin shpifjet dhe intrigat e tyre. Këta përhapnin dezinformata që godisnin thellë shoqërinë medinase. Ata dërgonin letra nëpër qendra të mëdha islame në emër të sahabëve të mëdhenj, si bie fjala në emër të Alisë, Talhasë ose Zubejrit. Në mesin e rebelëve ishte edhe Muhamed bin Ebi Bekër[7], Amar bin Jasir, Muhamed bin Xhafer dhe personalitete të tjerë të njohur. Çdo veprim i tyre fillonte në emër të Zotit dhe ata bënin salavate për Pejgamberin s.a.v.s., prandaj turmat i dëgjonin dhe habiteshin me atë që dëgjonin.

Askush nuk kishte menduar se një ditë do të arrihej deri tek atentati dhe vrasja e kalifit të muslimanëve. Këtë nuk e kishin në plan as shumica dërmuese e rebelëve, për të mos thënë të gjithë, me përjashtim të Abdullah Ibën Sebees.[8] E gjithë ajo që kërkonin rebelët gjatë rrethimit të Medinës, e më vonë të rezidencës së kalifit ishte dorëheqja e tij, ose dorëzimi i Mervan bin Hakem bin Ebi Asit. Rezidenca e kalifit ishte nën mbrojtjen e djemve të sahabëve më të shquar të historisë islame. Aliu kishte dërguar dy djemtë, Hasanin dhe Hyseinin. Aty ishte Abdullah bin Zubejri dhe qindra të tjerë. Gjatë një zënke të rastit, rebelët u përpoqën të hynin me forcë në shtëpinë e Osmanit r.a., por morën goditje të fortë. Në këtë zënkë u plagos Hasani, nipi i Pejgamberit s.a.v.s., ndërsa nga ana e rebelëve kishte të vrarë. Në anën tjetër, ushtria e Muaviut ishte nisur me njëzet mijë trupa në mbrojtje të kalifit pasi ishte informuar se në Medinë situata sa vinte e keqësohej.

Kur Osmani r.a. e pa se do të derdhej gjak midis muslimanëve për shkak të tij, ai ra dakord të bisedonte edhe një herë me rebelët e Egjiptit, ndërsa prej tyre (mbrojtësve të tij) kërkoi qw të largoheshin menjëherë nga shtëpia e tij. Marrëveshja përfundoi me largimin e Abdullah bin Sead bin Serrahit, mëkëmbësit të Egjiptit, ndërsa në vend të tij u emërua Muhamed bin Ebi Bekër. Por ajo që e acaroi situatën edhe më shumë, pas kësaj marrëveshje, ishte letra postale e



vulosur, e cila doli nga rezidenca e Osmanit në duart e djalit të tij, i cili kishte hipur në devenë e tij.

Letra i drejtohej Abdullahut, të parit të Egjiptit. Në të thuhej: 'Të vriten disa, të gozhdohen disa të tjerë dhe t'iu këpusin duart dhe këmbët disa të tjerëve. Kjo letër ishte bazuar në thënien e Allahut të Lartëmadhëruar i Cili në Kur'ani Kerim thotë: **"Pa dyshim se ndëshkimi i atyre që luftojnë kundër Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe që bëjnë shkatërrime në Tokë, është të vriten ose të gozhdohen, ose t'u këputen duart dhe këmbët tërthorazi, ose të dëbohen nga vendi. Ky ndëshkim është poshtërim për ata në këtë jetë, ndërsa në jetën tjetër, për ata do të ketë dënim shumë më të madh"** (Kuran, 5:33) Ibni Xheriri, në librin e tij të historisë, thekson se letra ishte shkruar nga Mervan bin Hakem bin Ebi Asi, i cili e kishte falsifikuar shkrimin e Osmanit, kishte gjetur rastin për t'ia vjedhur vulën e tij dhe kishte bindur djalin e tij që të dilte nga shtëpia për ta dërguar këtë letër shumë të rëndësishme për në destinacionin e kërkuar prej tij.

Pasi e lexoi Osmani letrën e kapur prej rebelëve, u habit. Gjithsesi, u orvat që t'i bindte se ai nuk e kishte shkruar atë letër, por më kot. Turma, nuk kishte kohë të gjatë për t'u menduar, ndërsa mbrojtësit e Osmanit ishin nëpër shtëpitë e veta. Ata duhej të vendosnin shpejt, t'i besonin Osmanit r.a. ose ta mbysnin dhe të largoheshin sa më shpejt që të ishte e mundur, sepse ushtria e Muaviut veç i ishte afruar Medinës. Në këtë rast, Abdullah ibn Sebee (çifuti i 'konvertuar'), shfrytëzoi rastin brilant dhe arriti t'i bindte rebelët se Osmani tani duhej mbytur dhe se ata duhej të iknin sa më parë. Me vendim të shpejtë, para namazit të xhumasë, në ditën e tetëmbëdhjetë të Dhul Hixhxhes të vitit 35 hixhrij, u vra mizorisht kalifi i tretë i muslimanëve. Osmani r.a. ishte i moshuar. Disa thonë se jetoi tetëdhjetë e tri vjet, disa të tjerët mendojnë se ishte më shumë. Ishte baba i katërmbëdhjetë fëmijëve. Thuhet se askush prej rebelëve nuk i shpëtoi vrasjes, përfshirë edhe Muhamed ibn Ebi Bekër, i cili u masakrua në mënyrë mizore dhe të turpshme. ■

---

1. Velid bin Ukbe, ishte akuzuar nga besimtarët se pinte alkool gjatë natës me disa persona të konvertuar në Islam, të cilët më herët kishin qenë të krishterë. Një ditë, Velidi ua kishte falur namazin e sabahut xhematit me katër rekate. Ai, nuk ishte penduar për këtë gabim, por iu kishte thënë, nëse doni ju fali edhe më shumë se katër rekate. Kur besimtarët e kuptuan se Velidi kishte qenë i dehur, e akuzuan te kalifi. Pa dyshim, Osmani e dënoi atë si të gjithë të tjerët, por për ta zbatuar vendimin e tij kërkoi nga të tjerët që ta bënin. Këtë e bëri Aliu (Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij) dhe Seid bin Asi.(Bidaje: 5/384 dhe Tarih Jakubi: 2/164)

2. Abdullah bin Sead bin Ebi Serrah, ishte një prej përshkruesve të parë të Kur'anit në kohën e Muhamedit s.a.v.s. Papritmas kthehet në xhahilijet te mushrikët e Mekës. Pas çlirimit të Mekës, Muhamedi s.a.v.s. ia fali gjakun pasi ndërmjetësoi Osmani r.a.. Por, vendimi ishte që ai të largohej përgjithmonë nga shoqëria muslimane. Transmetohet se Osmani e paska lutur Muhamedin s.a.v.s. pak para se të vdiste ta kthente Abdullahun në shoqëri me muslimanët, kërkesë e cila ishte pranuar sipas tij. Por këtë vendim nuk e kishte dëgjuar as Ebu Bekri e as Omeri. Kështu në kohën e këtyre dy kalifëve, Abdullahu e kishte të ndaluar të vinte në shoqërinë muslimane. Kur erdhi në pushtet Osmani e solli atë dhe, fillimisht, e emëroi këshilltar të tij, e më vonë e dërgoi në një pozitë shumë të lartë. Ai do të drejtonte Egjiptin në vend të Amër bin Asit, vend i cili u bë çerdhe e komplotistëve dhe e shkaktarëve të vrasjes së Osmanit r.a.

3. Për ngjarjet kronologjike të kësaj periudhe jam bazuar në të dhënat e Ibni Kethirit në librin e tij 'Bidaje dhe nihaje V-pestë' dhe nga Gjeneral Muhtar Pasha në librin e tij 'Tavarihul Hixhre' Libri I-rë.

4. Mervani ishte një prej kushërinjve të tij dhe njëkohësisht dhëndrri i tij.

5. Ibën Kethir, 'Bidaje we nihaje', botim i Asrije, Bejrut, V-5/ f. 398/9

6. Shumica ishin që t'i vritnin, derisa ishin pak në numër.

7. Muhamed bin Ebi Bekër ishte i vogël kur i vdiq babai dhe kështu ishte rritur në shtëpinë e Aliut r.a., pasi e ëma e tij ishte martuar me të. Pasi u rrit, u shpërngul në Egjipt dhe atje shpesh herë e shpërdoroi emrin e babit të tij dhe disa herë u dënua nga Osmani për vepra civile. Pas vrasjes së Osmanit, familja e tij e akuzojnë Aliun se kishte pasur gisht në vrasjen e kalifit të tretë, meqenëse Aliu kishte qenë kujdestar i Muhamed bin Ebi Bekrit.

8. Një ish-çifut i konvertuar në "musliman". Ky ishte linku kryesor i formacioneve rebele. Për të formuar këto çeta, këtij intriguesi ju deshën disa vjet. Thashethemet e tij, shpifjet ndaj Islamit dhe favorizimi i Aliut përpara kalifëve të parë, bënë që disa muslimanë të bëhen pre e deziformatave të tij. Njëri prej tyre ishte edhe Muhamed bin Ebi Bekr.

Inderuar vëlla musliman!

Po shkruaj pak me emocione, por kjo s'do të thotë se jam larg të vërtetës. Kjo s'do të thotë se do ta teproj në paraqitjen e fakteve dhe, po ashtu, s'do të thotë se kjo do të më ndihmojë ta zbukuroj atë që më duhet patjetër ta them, e që ty nuk të konvenon aspak.

Ne të dy besojmë në Një Zot, e adhurojmë Atë dhe secili, sipas mënyrës e mundësisë së vet, përpiqet që të arrijë kënaqësinë e Allahut të Gjithëmëshirshëm. Mirëpo edhe pse duket se jemi në frekuenca të njëjta, ne ndryshojmë për shumëçka. Islami juaj dhe Islami im kanë dallim. Nuk e di saktësisht përse, por mendoj se kjo është si rrjedhojë e perceptimeve të ndryshme. Ti e ke kuptuar ndryshe, kurse unë e kuptoj ndryshe. Ti je fokusuar shumë në formë, ndërsa unë në përmbajtje. Ti pasi ke arritur formën e dëshiruar, ke anashkaluar shumë gjëra që janë më të rëndësishme sesa forma e arritur. Nga ana tjetër, unë meqë jam në përpjekjet e stabilizimit të formës dhe ndihem më pak i brengosur për këtë, i përkushtohem më tepër përmbajtjes. Kjo na bën neve të dy që të shihemi me sy të tjerë. Kjo na krijon një ekui-distancë të panevojshme dhe sikur na thekson tej mase dallimet që kemi. Këtë e them për faktin se përkundër këtyre ndryshimeve që kemi, ne prapëseprapë kemi më shumë pika të përbashkëta që na njësojnë, sesa pika dallimi që na dallojnë. Që të dy synojmë të njëjtin qëllim, por rrugët i kemi marrë të ndryshme. Çfarë t'i bësh, njerëz jemi!!!...

Mirëpo sinqerisht dua të të them se mua më brengos gjendja jote, ashtu siç mund të të brengos ty gjendja ime. Nuk je i vetmi ti që me 'formën' e arritur më ke zhgënjyer, prandaj vendosa ta shkruaj këtë letër të hapur, me qëllim që kjo letër të kontribuojë në përmirësimin e përmbajtjes tek ata që kanë arritur formën e dëshiruar. Dua që kjo të shërbejë si model për të gjithë ata që duke u angazhuar shumë në formë, kanë harruar përmbajtjen, për ata që prioritet i kanë dhënë formës e jo përmbajtjes. Nuk dua të keqkuptohem. Ka edhe të atillë që angazhohen që krahas formës ta përsosin edhe përmbajtjen, prandaj kjo letër të mos kuptohet me steriotipe e paragjykime se dua t'i përgjithësoj gjërat. Assesi. Gjithkund ka përjashtime, por për fat të keq të rralla.

I nderuar vëlla musliman! Ti je në pozitë. Unë jo dhe sinqerisht nuk e dua atë. Për këtë kam dhënë prova. Kur më njoftuan me ty, unë u gëzova pa masë. Mendova se si musliman me formë të arritur, do të bësh të paktën më shumë se ata që nuk kanë as formë, as përmbajtje, madje as besim. Dhe pikërisht kjo është dobësia ime më e madhe që po më kushton qe njëzet vite, qëkur jam duke jetuar islamikisht. Po u besoj tepër atyre që kanë formë, pa menduar se në esencë mund të jenë të zbrazët. T'u luta të ma kryesh një punë që për mua kishte rëndësi jetike. T'u luta si vëlla, sepse je në një pozitë që atë punë mund ta kryesh me disa fjalë që nuk të kushtojnë as dy minuta kohë. T'u luta në Ramazan, natën e Kadrit, ndërsa ti u zotove se do ta kryesh dhe se do të më lajmërohesh. Kot prita. Ti harrove se premtimi është obligim. T'u dhimbën 5 cent për të më lajmëruar me mesazh në celular për: po ose jo. Të thirra unë, por ti e rrotullove: 'unë për lisa e ti për fshisa'. Deshti Allahu i Gjithëdijshëm që tri javë më pas të ma zbardhë para sysh përmbajtjen tënde. U gjendëm sy më sy mu përballë vendit ku ti duhej t'i thoshe vetëm dy fjalë për të më ndihmuar. T'u luta tërthorazi që ta bësh këtë, por ti nuk e bëre, bile fillimisht u shtire se nuk më njihje. Më the si me ironi: 'Mos ke dert se kryen punë!', pa ndërruar dy hapa për të ndihmuar kryerjen e asaj pune, edhe pse ishe në pozitë që fare lehtë ta bëje atë. Prita 7 orë në të ftohtë e në të nxehtë në këmbë dhe nuk kreva punë. I dëshpëruar u ktheva në shtëpi, ndonëse për të arritur atje kalova dhjetëra kilometra. Ta shkrova një mesazh në celular: "S.a vëlla, faleminderit dhe Zoti të shpërbleftë për angazhimin tuaj, por unë nuk kreva punë. Desha të të them vetëm këtë gjë: Posti është një sprovë prej sprovave të Allahut". Pas katër minutash më erdhi mesazhi juaj me këtë përmbajtje: "Me bo hallall qe s'pata mundesi te boj

Forma e bukur por përmbajtja brenda, bosh

dic mateper. Allahu ti lehtesoft rrugat!" Dua të them se në mesazhin tim s'desha t'i vendosja disa fjalë në thonjëza, duke menduar se ti do t'i kuptosh, por nga mesazhi kuptova se ti njëmend kishe kujtuar se unë mendoja se ti kishe bërë diçka, sepse kërkoje falje që s'ke mundur të bësh më tepër. Nuk e di si ke menduar se unë isha aq naiv që të mos e kuptoja se ti s'kishe bërë asgjë. Unë me sytë e mi të pashë se si ikje për të mos më bërë mirë edhe pse kishe mundësi, edhe pse ishe në pozitë që të më bëje mirë. Ishe përhumbur në krenarinë e postit dhe i kishe harruar fjalët e Zotit se muslimanët janë vëllezër, se duhet t'i ndihmojnë njëri-tjetrit, se duhet nxituar për të bërë mirë, e kështu me radhë.



I nderuar vëlla musliman! Nuk dua të zgjatem. E vërteta thuhet me pak fjalë. E vërteta s'duron fjalë stilistike e as metaforike, ajo thuhet troç e shtruar.



Deshi Zoti i Lartëmadhërishëm e më ndihmoi që ta arrij atë që kisha për qëllim në jetë.

Për këtë nuk kam pasur kurrë dyshim, sepse Ai ia ka bërë obligim Vetes t'u ndihmojë besimtarëve. Unë arrita, por ti kurrë nuk do të arrish më të më bësh mirë në këtë jetë, ti kurrë më nuk mund ta përsëritësh atë rast, prandaj nëse e kupton, ke lëshuar një rast të papërsëritshëm, për të cilin s'kam ide se si do të kalosh në Ditën e Gjykimit. Ti pate mundësi të më bësh mirë, por nuk deshe. Më kishe kërkuar të ta bëj hallall që s'e bëre atë, por e ke gabuar adresën. Mua personalisht nuk më ke obligim, por ty si çdo musliman të ka obliguar Zoti Fuqiplotë që të bësh mirë kur ke mundësi, e jo të ikësh, prandaj kërko që të ta bëjë hallall Zoti i Gjithëmëshirëshëm, Ai ndaj të Cilit ke obligim dhe i ke hyrë në hak.

Ne nuk jemi njohur kurrë më parë që të kishe diçka paraprakisht ndaj meje, prandaj sjellja juaj thjesht është vetëm tipar i personalitetit tënd, pra është rrjedhojë e asaj që thashë më parë: ti i ke kushtuar më shumë rëndësi formës sesa përmbajtjes. Gjithashtu kam parë se ky tipar karakterizon shumicën e atyre që kanë arritur formën, prandaj e shkrova këtë që të shërbejë kjo si alarm për ta përsosur sa më shumë përmbajtjen.

Duke e parë përplasjen formë-përmbajtje, që fatkeqësisht është bërë modë e shumë muslimanëve të sotshëm, personalisht kam vendosur që më tepër t'i përkushtohem përmbajtjes sesa formës, pa e anashkaluar në asnjë mënyrë përpjekjen që të arrij deri te forma, atëherë kur të më ketë hije për përmbajtjen. Këtë dua ta arrij jo deklarativisht, por para së gjithash me vepër. Ma merr mendja se s'ka rëndësi nëse molla ka ndonjë etiketë në lëvore apo jo, nëse në brendi është e shëndoshë. Ose më konkretisht, do të ishte më mirë që ta bëjmë sa më të shëndoshë përmbajtjen se sa t'i përkushtohemi formës. Forma e ka hijeshinë e plotë vetëm kur ka përmbajtjen e mirë. ■

R.Xh

Sfidat e njeriut bashk përballë rreziqeve ma



Iljasa SALIHU

Gjatë tërë historisë së tij, njerëzimi ka qenë i kërcënuar dhe i rrezikuar me zhdukjen e tij, për shkaqe të ndryshme dhe të shumta. Disa prej shkaqeve ndër më kryesorë ishin: luftërat, tërmetet dhe varfëria. Para se të bëheshin shtetet, ishin bërë mjaft luftëra për zgjerimin e territoreve, pushtime të vendeve të huaja, pushtime për shkak të resurseve, si dhe pushtime për shkak të dominimit dhe të udhëheqjes së botës. Njeriu në vazhdimësi ishte gjendur përballë kanosjes dhe rrezikut, si dhe në kuadër të parandalimit të tyre, e kishte pranuar luftën ndaj rrezikut si gjë normale dhe të domosdoshme! Disa shtete, me mundime të shumta, duke mos e zgjedhur rrugën deri te caku final, kanë arritur të bëhen lidere karshi shteteve të tjera. Kjo ishte thjesht një vetëmbrojtje nga kërcënimi i mëtutjeshëm. Një logjikë të tillë lashtësie të njerëzve dhe të shteteve e hasim edhe në kohërat e sotshme. Në kohërat e sotshme shohim veprimet dhe garat e shteteve, për arritjen e pozitës së "sunduesit të botës". Por, krahasuar me kohërat e kaluara, sot kjo arritje madhore nuk bëhet më me anë të luftërave shtetërore për ndryshimin e kufijve apo për pushtimin e shteteve të pranuara ndërkombëtarisht, por me anë të të arriturave diplomatike, ekonomike, shkencore dhe teknologjike. Me automatizëm me këto të arritura kuptojmë edhe sofistikimin e armëve, participimin në ushtri apo edhe thithjen e trurit nga vendet e zhvilluara. Një e arritur madhore dhe një demonstrim i forcës ndaj shteteve të "padëgjueshme" është edhe formimi i organizatës politike-ushtarake të NATO-s.

Paralelisht me zhvillimin e teknologjisë janë rritur kanosjet dhe rreziqet ndaj njeriut! Me zhvillimin e shkencës, e cila ishte shumë e dobishme për njerëzimin në përgjithësi, u zbulua edhe atomi. Fillimisht pati një huti rreth përdorshmërisë së atomit (bile edhe nga vetë zbuluesi i tij). Sot bota dhe njeriu gjenden në rrezik përballë këtij zbulimi gjigant, ose atyre iu kanoset zhdukja e tërësishme. Mjafton një kryetar gjysmë i çmendur i shteteve poseduese të atomit, që e tërë bota organike dhe inorganike të marrë fund.

Një kërcënim dhe rrezik serioz ndaj njeriut është terrorizmi. Fillet e terrorizmit janë të hershme, qysh se kur një njeri, apo një grup njerëzish kryenin krime ndaj një individi, apo ndaj një grupi individësh civilë, apo ndaj caqeve ushtarake të pafajshme. Terrori i 2001-shit, ndaj kullave binjake dhe Pentagonit në ShBA, arriti kulmin dhe propagandën e tij.



Pas vitit 2001, nën pretekstin e luftimit dhe çrrënjosjes së terrorizmit, terrorizmi filloi të rritet dhe zgjerohet akoma më tepër. Paradoks! Sepse parandalimi i terrorizmit tentohej të bëhej me anë të terrorit shtetëror ndaj popullatës civile në Lindjen e Mesme. Sot është e pamundur t'i dëgjojmë lajmet, ose t'i shfletojmë gazetat, e të mos shohim ngjarje të tmerrshme, vrasje, masakrime dhe përdhunime në Lindjen e Mesme.

Pra, nga ky fenomen famëkeq, njeriu bashkëkohor, në përgjithësi, është i shoqëruar me pasiguri totale dhe është i privuar nga të jetuarit e një jete të dinjitetshme.

Njëri prej problemeve dhe rreziqeve kryesorë të njerëzimit në të ardhmen, është ngrohja globale e tokës. Ky fenomen shkaktohet për shkak të dëmtimit permanent të shtresës mbështjellëse të ozonit, që e përshkon globin tokësor. Ky rrezik global për njeriun po bëhet nga vetë dora e tij, gjegjësisht përmes prodhimit dhe përdorimit enorm në industri të dyoksidit të karbonit dhe metanit, të cilët shpërndahen në ajër përmes tubave të ndryshme të përdorimit ditor, si: ngjyra, parfume dhe mbushje të tjera. Rrezikun dhe pasojat në fjalë, tashmë veç i kemi të njohura! Shumë vise me klimë të ndryshueshme kontinentale, kanë filluar të ballafaqohen me temperatura mjaft të larta. Në disa regjione të botës, stinët nga viti në vitit kanë filluar të ndryshojnë. Po ashtu, kemi edhe një rivalitet mes dy ish-superfuqive të botës. Në njërën anë, Rusia ka tendenca t'i japë zgjidhje shkencore këtij problemi dhe, në anën tjetër, SHBA-ja ka plan-programet e veta për zgjidhjen e këtij problemi kërcënues dhe global. Besimi i opinionit për një zgjidhje efikase mbështetet te SHBA-ja.

Problem tjetër global për njeriun është paraqitja e krizave ekonomike. Pas krizës së madhe

këkohor adhore!

financiare, të ashtuquajtur "depresion i madh i viteve 30-ta", aktualisht njerëzimi dhe ekonomitë shtetërore përballen me krizë financiare globale, edhe pse aktualisht ka zëra se bota, në përgjithësi, është duke e rimarrë veten në aspektin e përmirësimit ekonomiko-financiar, por, sidoqoftë, ende ekzistojnë rreziqe rreth krizës në fjalë. Shkaqet e paraqitjes së kësaj krize ishin dhe janë të ndryshme dhe të shumta. Një ndër to ishin dhe janë: falimentimi i bankave nga moskthimi i kredive afatshkurtra dhe afatgjata, normat e larta të kamatës, lufta në Lindjen e Mesme, kriminaliteti ekonomik, konkurrenca jolojale e Kinës në tregun ndërkombëtar... etj.

Dihet mirëfilli se me kushte dhe kriza të vështira sociale do të shoqërohemi në vazhdimësi, të cilat, më pastaj, mund ta humbin kuptimin ekonomik dhe të marrin kuptimin tjetër, pra atë ushtarako-shkatërrues. Edhe krizat e njëpasnjëshme financiare, edhe mosefikasiteti i politikave shtetërore, përbëjnë një kërcënim dhe rrezik serioz për shoqërinë njerëzore në përgjithësi.

Krijesa e quajtur njeri, gjendet edhe përballë shumë kërcënimeve të tjera. Në një të ardhme jo fort të largët, në bazë të parashikimeve të shkencëtarëve, njeriu do të ballafaqohet me problemin e ujit të pijshëm. Botën e tretë prej kohësh e kanë kapluar krizat ushqimore! Po ashtu, sëmundjet nga marrëdhëniet seksuale të jashtëligjshme vazhdojnë të jenë akoma preokupim dhe problem serioz për njeriun. Këto dhe shumë rreziqe të tjera ndaj krijesës më të bukur në rruzullin tokësor, paraqiten për një arsye të vetme.

Pra, për humbjen e vlerave të mirëfillta morale! Pothuajse nuk ka vend ose truall në botë ku nuk kanë humbur vlerat morale njerëzore. Sot, shtetet e zhvilluara i shohim me një progres tekniko-shkencor marramendës, por në anën tjetër këto vende i shohim me një rënie moralo-shpirtërore marramendëse. Prandaj, zhvillimi dhe përparimi duhet të shkojnë konform bashkëveprimit të normave morale e shpirtërore në shoqëri. ■



"Paqja studentore" në mesin tuaj



Mevlude ZEJNULLAHU

Organizata "Paqja studentore" e Universitetit të Prishtinës, në kuadër të aktiviteteve që organizon, në fillimin e vitit akademik 2009/2010, ka shpërndarë 1 000 fletushka për të gjithë studentët e fakulteteve, në të cilat janë paraqitur të drejtat e studentëve.

Hysni Mustafaj, kryetar i "Paqes studentore", bëri me dije se kjo iniciativë është në vazhdën e punëve që organizata i ka vënë vetes si prioritet.

"Të gjithë anëtarët, në veçanti kryesia, kanë punuar në baza vullnetare për përpilimin e kësaj fletushke, në mënyrë që ajo të jetë e dobishme për të gjithë studentët, dhe jo vetëm për ata të cilët i kanë filluar studimet këtë vit".

Në këto broshura janë paraqitur të drejtat e studentëve të Universitetit të Prishtinës, në bazë të ligjit të këtij universiteti.

Nexhmedin Rexhaj, student i Fakultetit Filozofik, u shpreh mjaft i kënaqur derisa e lexonte fletushkën për të drejtat e tij si student. "Për ne që kemi filluar studimet tani, kjo fletushkë që më ra sot në dorë është një udhëzues shumë i qëlluar, pasi na tregon se çfarë të drejtash kemi, si edhe natyrisht se cilat janë përgjegjësitë tona".

"Paqja studentore" ka më shumë se 7 000 anëtarë. Aktivitetet e saj janë të shumta dhe të shpeshta. Ajo është themeluar për të bërë ndryshime në UP dhe, njëkohësisht, për t'i kontribuar zhvillimit pozitiv.

Kjo organizatë nuk ndalet së punuari për të mirën e studentëve. Ajo nuk i shton aktivitetet vetëm para fushatës zgjedhore, siç jemi mësuar rëndom me të tjerat, por angazhohet dhe punon pa u ndalur. Sigurisht se ky moral i saj ka bërë që ajo të fitojë besimin e pjesës më të madhe të studentëve të UP-së. ■



Për maturantët dhe studen



Jeton ISUFI

Duke pasur parasysh kohën dhe vendin në të cilin jetojmë, rrethanat e kushtet nëpër të cilat kalon vendi ynë, proceset të cilat po rrjedhin këtu, problemet e sfidat që po e godasin shoqërinë kosovare në përgjithësi, e rininë në veçanti, "ajka" e së cilës janë pa dyshim studentët, atëherë ia vlen që atyre t'u jepet një orientim ose këshillë e që, më pastaj, kjo t'u shërbejë për një përcaktim të drejtë dhe për një orientim adekuat të jetës studentore. Meqë kjo kategori është më shpresëdhënësja për shoqërinë, orientimi i saj për qasjen dhe kuptimin e drejtë të çdo rrethane a problemi me të cilin do të ballafaqohet, e ka rëndësinë e vet në të ardhmen dhe në perceptimin dhe zgjidhjen e problemeve me te cilat, pa dyshim, ata do të ndeshen në të ardhmen.

Studenti, para se të fillojë drejtimin të cilin ai ose ajo e ka zgjedhur, duhet t'i parashtrojë disa pyetje vetes në mënyrë që kur t'i fillojë studimet të mos dëshpërohet, e që më pas ky dëshpërim të reflektojë në masë të madhe në suksesin e tij.

Pyetjet që secili duhet t'ia parashtrojë vetes janë:

1. Çfarë dëshiroj të studioj?

2. Ku ka nevojë më shumë për kuadro?

3. Cili është qëllimi që do të arrij me këtë studim?

1. Secili duhet të zgjedhë drejtimin që dëshiron, por para se të zgjedhë është e udhës që të këshillohet me dikë që ai mendon se e ndihmon në përzgjedhjen e drejtë të profesionit të tij, pasi që në atë profesion ai do ta kalojë jetën e tij dhe duhet të shikojë mirë se ku ka nevojë më shumë për kuadro të reja, pasi dikush mendon se disa drejtime janë më pak të rëndësishme, e më pas vjen koha që duhet të importojmë kuadro të tilla, për arsye se të gjithë jepen pas një drejtimi, e pasojat do t'i bartim në të ardhmen.

Pra, duhet të mendojmë mirë për zgjedhjen e drejtimit që do të studiojmë, e pasi të zgjedhim të mundohemi ta përsosim atë drejtim, me qëllim që dikush nga ne të dalë specialist i atij drejtimi, e të mos kemi nevojë të sjellim kuadro nga jashtë.

2. Pyetja e dytë që duhet të parashtrohet është se çka dëshiron studenti apo studentja të arrijë me studimin e tij apo të saj. Studenti nuk duhet të ketë vetëm synime personale me rastin e përfundimit të studimit të tij, por me përgatitjen dhe të arriturat e tij gjatë studimeve, ai duhet të bëhet shkaktar për ndryshime në të mirën e shoqërisë ku ai jeton, si dhe në rrethin ku ai ka ndikim.

Si çështje të tjera për të cilat duhet të interesohet studenti, por edhe të kujdeset, janë edhe: informimi, morali i përgjithshëm dhe pjesëmarrja në jetën organizative studentore.

1. Informimi - Çdo student duhet të jetë i informuar për çdo gjë që ndodh rreth tij, si dhe për organizimin e jetës politike dhe ekonomike që bëhet në vendin e tij. Përmes informimit të jetës reale që bëhet rreth tij dhe në vendin e tij, ai i percepton më lehtë gjërat, si dhe qasja e tij për studim është më e kujdesshme,



ntët e rinj

sepse duke i parë lëvizjet që ndodhin në vendin e tij por edhe më gjerë, ai përgatitet për zgjidhjen e problemeve të ndryshme shoqërore.

2. Morali i përgjithshëm - si element i rëndësishëm në një shoqëri të shëndoshë - pa dyshim se është një ndër çështjet bazë. Studentët, si kategori e veçantë e shoqërisë, duhet ta kenë këtë virtyt të lartë njerëzor dhe të veprojnë në përputhje me të.

3. Pjesëmarrja në jetën studentore organizative realizohet përmes pjesëmarrjes në organizatat studentore, përmes projekteve të ndryshme, qofshin ato humanitare apo në promovimin e vlerave njerëzore, ose në luftimin e dukurive negative. Ata sjellin mesazh të mirë te të gjithë qytetarët dhe një shpresë për ta se do të presin ditë të mira nga elita studentore. Të gjitha këto angazhime mund të kryhen pa e dëmtuar procesin mësimor, ose më mirë të themi ato veçse e pasurojnë kapacitetin e tyre intelektual dhe profesional. ■

Autori është nënkryetar i Parlamentit të Studentëve të Universitetit të Prishtinës





Këshilla një gazetari

Faik Konica boton në të përkohshmen "Albania" me datë 15 shtator 1901, këshillat pasonjëse për një djalë që kish nërment të botonte një gazetë shqip në Misir.

I dashur mik - në e bëfsh gazetën me fleta të mëdha; shqiptarët do të thonë që s'fshihet dot lehtë; në e bëfsh me fleta të vogla, do të thonë se s'është gazetë, por libër. Në e shtypsh me letra të holla, do të thonë se s'këndohen edhe prishin sytë; në e shtypësh me letra të trasha do të thonë se je "hamall" e kërkon të mbushësh vend. Në shkrofsh toskërisht, do të thonë se s'është gazetë për gjithë shqiptarët; në shkrofsh gegnisht prapë"ashtu, në shkrofsh në gjuhë të përzier me të dyja, gjysmë gegnisht, gjysmë toskërisht, do të thonë se është "çervish".

Në mos shkrofsh për politikë, do të thonë se s'është koha të punojmë për letratyrë, kur vendi ndodhet në rrezik; në shkrofsh për politikë do të thonë se prishë punë duke egërsuar qeverinë. Në folsh butë për Turqinë, je i paguar prej Stambollit; në shkrofsh rreptë kundër Turqisë, kërkon të të jap Sulltani të holla që ta pushosh gazetën. Në mos gjetsh të holla që ta mbash gazetën, do të thonë se s'je i zoti, me qenë aq njerëz duan zgjimin e kombit shqiptar; në gjetsh të holla je intrigant a i shitur. Në folsh për plot çlirimin e Shqipërisë, do të thotë je djall e kërkon gjëra që duheshin gatitur në qind vjet më parë; në folsh për nevojën të përpiqemi ta shpëtojmë gjuhën dhe kombësinë, duke vënë vendin nën hijen e një Fuqisë së Madhe, s'qenke shqiptar i vërtetë.

Në folsh mirë për shqiptarët e krishterë, hidhërohen shqiptarët muhamedanë; në folsh mirë për muhamedanët, hidhërohen të krishterët; në folsh mirë për të krishterët e për muhamedanët që janë shqiptarë të mirë, e ligsht për të ligët, ahere do të hidhërohen të gjithë. Aq për sot, se kam frikë mos të zërë gjumi. ■

Faik KONICA

Gazeta "Dielli", 10 prill 1957




Vështrim arti


Rrëfim mbi shekullin e hu

Antihumanizmi në shoqërinë moderne, thotë Sabato, e ka shndërruar botën në kaos. Si rrjedhojë e kësaj të vërtete libri përcjell një mesazh, i cili sado që idealist, është program autorial që kërkon të nxisë solidaritetin te njerëzit për të themeluar një "botë të re", larg botës së molepsur nga tmerret, torturat dhe gjenocidet

Blerina Rogova - Gaxha


Ernesto Sabato

Ernesto Sabato edhe dy vite bën një shekull jetë (1911). Para se t'ia hapë derën vdekjes ai vendosi të shkruajë kujtimet e veta në librin e titulluar "Përpara fundit" (Rrëfim mbi një shekull). Rrëfimin për fatin e vet, Sabato e thur si rrëfim të një ekzistence nëpër etapa të ndryshme të jetës; nis me fëmijërinë, rininë, punën, shkencën dhe, në fund, me letërsinë. E kush do ta besonte se njeriu i shkencës do të përfundonte në njeri të letrave?! Asnjë njeri nuk e di se kush është - pohoi Leon Bloy. Ernesto Sabato diplomoi në fizikë, u mor gjatë me shkencë, por e braktisi atë për të zbuluar vetveten në letërsi, për t'i ikur botës së egër për të cilën dyshoi gjithnjë. Në kufirin e jetës, ai shkroi epilogun, ose testamentin shpirtëror: "Jeta ime duket se po shkon drejt sosjes, si "Tuneli", me dritare e galeri paralele, ku gjithçka është pafundësisht e pamundur. Sa i çuditshëm, sa i tmerrshëm është fakti se me afrimin e vdekjes rikthehen këto metafora të trishtueshme!" Jeta për vetë autorin është pikërisht si në veprën "Tuneli": një tregim i errët i vetmisë dhe izolimit. Po të qe letërsia shkencë do të mjaftonte një kombinim i mirë variacionesh për të nxjerrë një libër të lexueshëm. Sabato e dinte këtë. Ai luftoi me veten dhe me botën përreth, vrau shkencëtarin dhe lindi letrarin, duke iu përkushtuar asaj që i flinte në shpirt.



Novela psikologjike e rrëfyer në veten e parë "Tuneli" (1948), që konsiderohet si kryevepër e tij, trajton paaftësinë e njeriut për ta liruar veten nga komplekset. Vepra rrëfen se si një njeri inteligjent mund ta çojë veten deri në çmenduri dhe të bëhet një kriminel nga pasiguria dhe obsesioni që ka për gruan. Të tjera vepra, po aq të njohura sa "Tuneli", janë: "Mbi heronjtë dhe varrezat" (1962) dhe "Engjëlli i errësirës" (1974).


Ekzistenca e dyfishtë

Gjatë leximit të librit është e lehtë të kuptosh se autori s'deshi tjetër pos fatit të vet. Atë njeri e pashë të kërkonte si i egër dritën e fshehtë, mes ditës dhe natës, mes rregullit dhe kaosit, që shumë herë kërkohet pa e ditur se çfarë. Ekzistenca e dyfishtë të thërret të bësh atë që e shtyjnë forca të lashta. Sabato në gjysmën e jetës do të ndeshet me krizën që do ta ndante atë nga shkenca për t'i shërbyer artit. Letërsia e lejoi të shprehë pamje të lemerishme e kontradiktore të psikikës, shpesh përtej asaj çfarë vetëdija e lejon. Ai u bë kokëfortë në këto kriza shpirtërore, i bindur se arti ishte "thirrja", që i qëndron besnik unit dhe qenies. Pas Luftës së Dytë Botërore u thirr për një detyrë në Paris, pranë UNESKO-s. Në këtë kohë hyri në mjedisin e botës së errët të surrealistëve dhe u njoh me ajkën e kësaj kulture dhe me personalitete autoritative. Endja nëpër një univers kafkian e çoi në një depresion të thellë. Kriza e shtyri të nisë historinë e një piktori, i cili kërkon në mënyrë të dëshpëruar të komunikojë. Pas kësaj, të shkruarit u bë mjeti bazë që e lejoi të shprehë kaosin ku përpëlitej, e i dha mundësi të ikë nga ferri i vetvetes. Krijimtaria qe ajo që e ndihmoi të dalë nga depresioni, t'i ikë idesë së vetëvrasjes, e të gjejë diku njëfarë paqeje shpirtërore.

Katarsisi kolektiv

Antihumanizmi në shoqërinë moderne, thotë Sabato, e ka shndërruar botën në kaos. Si rrjedhojë e kësaj të vërtete libri përcjell një mesazh, i cili sado që idealist, është program autorial që kërkon të nxisë solidaritetin te njerëzit për të themeluar një "botë të re", larg botës së molepsur nga tmerret, torturat e gjenocidet. Në epilog autori kërkon një "Pakt mes të humburve" duke i bërë thirrje njeriut për humanizëm për të mbijetuar, meqë ai e konsideron krejtësisht të vetmuar njeriun bashkëkohor: "Po të flas ty dhe nëpërmjet teje gjithë të rinjve". Me

...manistit



fjalë të tilla autori i drejtohet rinisë me shpresë për ta ruajtur botën, me shpresë që atë që qeveritë e kanë harruar ta bëjë solidariteti njerëzor. Këtë angazhim ai e sheh si një mision.

Ernesto Sabato njihet botërisht si novelist dhe kritik letrar. Po ai ishte edhe humanist, një aktivist politik dhe antiperonist i fuqishëm. Në vitin 1984 shkroi një reportazh të ashpër për viktimat e zhdukura gjatë regjimit militant argjentinas. Luftërat që ndodhën në shek. XX-të e bënë atë ta humbiste besimin në të mirën njerëzore dhe të besonte se bota është përpara fundit. Dhe frika se ndoshta dhe ai vetë do ta presë këtë fund, e shtyu që të dojë më pak një jetë sesa një art të gjerë dhe kompleks. Fjalët e tij depërtuan edhe te shqiptarët e izoluar në kohë dhe në hapësirë. I lindur nga një arbëreshe e Kalabrisë, ai u ftua në tokën e të parëve, në vitin 1996 për të marrë Çmimin Kadare. Vizitën në Tiranë e konsideroi si një nga më emocionueset e gjithë jetës: "Ata njerëz të vuajtur, ata heronj më pritën si një bamirës, si një mbret, si një bir të dashur". Ky bir shqiptareje beson se janë martirët ata që mbijetojnë në mjerim. Miliona qenie që shndërrohen në heronj. Dhe është bota e tërë ajo që ka nevojë për një katarsis shpirtëror. ■



Kritikë

Tiparet shënjuese

Poezia sa vjen e bëhet më e hapur si tërësi estetike në lexim. Shenjat kuptimore, të shtresuara në formë të diskursit/poezisë, gjatë leximit e interpretimit bëhen shenja universale. Këtu, bota personale bëhet botë universale



Flamur MALOKU

Poezia e Hasije Selishtës Kryeziut, formulohet duke krijuar një sistem të *ligjërimit/figurimit*. Ligjërimi, në tekst bëhet ligjërim i figurshëm i shtresuar në variante, që njëherësh bëhet shenjë e identifikimit për *tekstin-poezinë*, gjithnjë duke e përforcuar figurën e tekstit, e cila bëhet shenjë themelore e kuptimësisë. Figurat formësohen në diskursin e tekstit, gjithnjë në funksion të semantikës. Poezia sa vjen e bëhet më e hapur si tërësi estetike në lexim. Shenjat kuptimore të shtresuara në formë të *diskursit/poezisë*, gjatë leximit e interpretimit bëhen shenja universale. Këtu, bota personale bëhet botë universale. Dihet se diskursi universal i poezisë, jeton gjithnjë duke shënjuar kuptime. Nga kjo figurat e tekstit ndërlidhen, çdoherë në sintetizim të *idesë/tematikës*. Mbi këtë parim mundësohet edhe analizimi i kodit tematik, gjithnjë më qëllim të identifikimit të vetë strukturës poetike. Struktura e tekstit analizohet përmes esencave shënjuese, të cilat reflektohen në poezi. Esencat shënjuese artikulohen në tërësinë e shkrimit fiksional, çdoherë duke njohur e rinjohur *relacionet/komunikimet*, e shumta diskurseve tematike.

Zbrazëti/vetmi

Variantet e shumta personale shtresojnë *tema/mbitema*, të cilat në poezinë e Hasije Selishtës Kryezi-ut artikulohen nga një gjendje shpirtërore përplot emocione. Gjendja shpirtërore-subjektive portretizohet përgjatë realizimit të shkrimit fiksional. Individualja bëhet e *ndjeshme/emocionalizuese*, që në poezi paraqitet me një dhembje e dëshpërim. Pra, jepet dhembja e dëshpërimi, karshi kohës e situatës. Koha dhe situatat e përjetuara në shpirtin e subjektit bëhen *zbrazëti/vetmi*. Kjo e rrit edhe më shumë dramatikën e tekstit. Pa dyshim, ballafaqimi me situatën, në strukturën e poezive, preket e shqyrtohet, gjë që shndërrohet ngadalë në përjetim të rëndë. Përjetimet e figuruara marrin gjithnjë dimension të theksuar konotimi. Konotimi i tekstit, bëhet përfaqësim e theksim i *Botës-Jetës/Ekzistencës*. Lufta personale dhe ballafaqimi për një ekzistencë jetësore bëhet pre-

→

okupim shpirtëror e fizik. Mbi këtë ide subjekti ndërton e rindërton vuajtjen e madhe. Jo rastësisht ligjërimi identifikohet e figurohet me mollën e rënë para kohe: *Nën degë molla e rënë/ Para kohe/ E papjekur po kalbet*. Këto mendime të shprehura në tekst japin atë që quhet vuajtje e brendshme individuale, që del ashtu në heshtjen personale, përballë vështirësive jetësore të të qenit femër. Zbrazëtia e krijuar shpirtërore dhe pamundësia e veprimit e bën poeten të ligështuar dhe të ndjeshme. Pra, mungon forca e veprimit. Mbi këtë mungesë veprimi lindin në diskurs edhe kontrastet ideore, të cilat në përgjithësi të sistemit ndërtojnë figurën, duke u bërë para së gjithash edhe shprehje e një revolte subjektive. Kontrastet e shumta në strukturën e tekstit venerohen dukshëm. Ato dalin kushtimisht nga rrafshi i pamundësisë. Edhe pse pamundësitë janë të shumta në jetë, e përgjatë jetës, shprehja personale-subjektive gjithmonë rri larg deklarimeve. Deklarimet nuk i pranon *figura/tematika* e poezive.

Venerim përmbyllës

Duke i parë të gjitha thyerjet shpirtërore në jetë dhe pamundësitë e veprimit e të qenit femër, poezitë në esencë nuk e japin asnjëherë dorëzimin personal karshi jetës. Vuajtja, që njihet si shenjë personale, gjatë shkrimit bëhet e prekshme, sugjeruese e identifikuese për *(Tjetrin)*. Kjo bëhet edhe status i kodit llojor, përgjatë *kategorizimit/shkrimit*. Hapësirat shtresore dhe thyerjet konvenciale funksionojnë përherë në të mirë të *diskursit/tematikës*. Kërkimi i vazhdueshëm i shtresave të përvojës autentike, në gjithë poezinë, bëhet *themelor/përcaktues*. Komunikimi i shprehur sa vjen e përforcohet. Mbi këtë, autentikja nis e hapet në diskurs të përhershëm. I gjithë pasqyrimi i vuajtjes e i trishtimit, në kohë përjetimi, formohet në shenja e variante të relativizuara. Pra, jeta relativizohet në rikthim nga figura, në variante të shumta. Në këtë mundësi të shprehjes, skema thyhet dhe jeta bëhet *figurë/shkrim*. Duke qenë kështu, vargu i poezisë nuk mbingarkohet në kuptimësi, përgjatë një bote fiksionale. E gjithë kjo poezinë e Hasije Selishtës Kryezi-ut e bën të jetë më pranë lexuesit të dashuruar me diskursin e poezisë. ■

Kultura dhe shtyp



Astrit VELIQI

Kultura konsiderohet si njëra nga sferat më të rëndësishme të shoqërisë në përgjithësi. Por e keqja më e madhe është se te ne nuk i jepet rëndësi dhe mbështetje këtij sektori krucial, edhe pse sektori kulturor është një prej elementeve që pa dyshim krijon edhe imazhin e parë jo vetëm për qytetarët, por edhe më gjerë. Por, sa i jepet realisht hapësirë këtij fenomeni në shtypin ditor në Kosovë? Kësaj pyetjeje është tepër vështirë t'i jepet një përgjigje strikte, megjithatë një vlerësim i tillë duhet të mbështetet në gjykimin e specifikave aktuale që mbizotërojnë kudo në shtypin tonë ditor.

Nuk thuhet kot se kultura është shpirti i një kombi dhe nga një shpirt i tillë brumosen gjenet dhe edukata familjare e sociale në përgjithësi.

Por siç dihet sferat kulturore në Kosovë, ku hyjnë arti, filmi, muzika, letërsia, poezia, sporti etj, nuk e kanë nivelin dhe hapësirën e duhur si sektor shumë utilitar e human, ngase pengesë në këtë plan janë shumë faktorë që, në radhë të parë, do të mund t'i emërtonim për nga natyra si njerëzorë, ekonomikë, por edhe profesionalë. Faktori njeri është ai që në rastet më të shpeshta bëhet pengesë e pakapërcyeshme për t'i dhënë sferës kulturore vendin e merituar në shtypin ditor e periodik te ne.

Në këtë plan, ajo që i mban pezull bosët e shtypit ditor te ne është ana materiale dhe biznesi, karshi anës shpirtërore, ose më mirë të themi kulturore. Pikërisht një qasje e tillë mendoj se është e gabuar, ku humbës në këtë lojë gjithnjë mbesin lexuesit, ndërsa fitues janë ata që i udhëheqin këto politika mediale në Kosovë. Një koncept i tillë do të duhej që së paku të vlerësohej për të bërë hapin e parë për ndryshim nga faktorët institucionalë të kulturës në Kosovë.

Shkrimet kulturore të pastimuluara

Problem tjetër në këtë mes është edhe stimulimi shumë i dobët, si institucional ashtu edhe ai medial, ndaj krijuesve dhe autoriteteve të kulturës në veçanti, pasi vlerat krijuese e kulturore jo vetëm që nuk vlerësohen, por edhe nuk stimulohen në formën e duhur.

Në këtë çështje konsideroj se problemi, përveç që është material e shpirtëror, është në të njëjtën kohë edhe pengesë e shkaktuar nga legjislacioni ligjor, i cili në përgjithësi, përveçse në letër, nuk gjen zbatim tjetër praktik. E faktori i tretë është më i vështiri për t'u vlerësuar ngase nuk është vetëm dija ajo që i mbyll përfundimisht 'vrimat e gardhit', por gjithashtu edhe ekspertiza profesionale është një prej faktorëve shumë domethënës në promovimin e sektorit kulturor, e kjo e fundit konsideroj se mbetet një sfidë që po na kushton shumë.

Megjithatë, pa një organizim të gjithanshëm, ku do të plekseshin të gjitha mekanizmat bazë, si ato ligjore, njerëzore e sociale për t'i vënë në veprim proceset kulturore, një ndryshim eventual do të mbetet i vështirë për të ndodhur.

Hapësira kulturore në gazetat tona

Por cila është gjendja aktuale dhe cili është vendi i sferave kulturore në shtypin ditor të kohës sonë? Bazuar në veçanti te gazetat ditore te ne, shohim se hapësira rrugëton nëpër një vijë lineare lindje-perëndim.

Gazetat ditore që i japin hapësirë më të madhe komponentëve kulturorë në Kosovë janë: "Koha ditore", "Zëri", "Kosova Sot", "Express" e më pak gazetat "Lajm" "Epoka e Re", "Infopress", etj.

Në gazetën "Koha ditore", pothuaj çdo ditë kemi nga dy faqe me shkrime të ndryshme kulturore, si nga ngjarjet protokollare ditore, po ashtu edhe artikuj të ndryshëm nga sektorët kulturorë nga vendi e më gjerë.

Sikurse tek disa gazeta të tjera, edhe te kjo e përditshme të dielën është shtojca kulturore me disa faqe gazete, ku prezantohen artikuj kulturor nga më të ndryshmit, si nga arti, muzika, filmi, letërsia, përkthime të ndryshme etj.

Në këtë gazetë, edhe pse ka një laramani lajmesh, raportesh, artiku-

i ditor në Kosovë

jsh, fejtonesh nga sfera kulturore, megjithatë, hapësira për krijuesit e rinj dhe talentet e ndryshme është shumë e vogël, për të mos thënë nuk ekziston fare. Pikërisht për këtë, vlerat kulturore vyshken që në lulëzim dhe si të themi u ndalet rritja, ngase pikërisht të rinjtë janë ata që e pasurojnë botën dhe shëmbëlltyrën krijuese në Kosovë. Përkundër të gjithave, kjo e përditshme konsiderohet nga qytetarët si më profesionale dhe elitare në raport me gazetat e tjera. Hiç më cilësore se e para nuk është edhe gazeta tjetër ditore "Zëri", e cila në përditshmërinë e saj pothuaj ka një apo eventualisht dy faqe me artikuj kulturorë, kryesisht me lajme ditore, por edhe me artikuj të ndryshëm kulturorë.

Kjo e përditshme në shtojcën kulturore, që e ka ditën e shtunë, paraqet një sërë artikujsh të ndryshëm nga sfera të ngushta kulturore si arti, muzika, filmi, letërsia etj.

Përkundër të parës, kjo gazetë i jep më shumë hapësirë talenteve të reja krijuese, të cilët prezantojnë idetë e tyre profesionale, por edhe studimore. Kjo gazetë ndan edhe një vlerë të vogël të hollash, në formë honorari, për botimet e shkrimeve kulturore.

Ndërsa gazeta "Kosova Sot", i kushton kulturës hapësirën e një faqeje gazete, ndërsa shtojcën kulturore e ka të dielën. Zakonisht në shtojcën e kësaj të përditshmeje kemi një intervistë me një nga figurat dhe autoritetet e sferës kulturore, mandej ka lajme të shkurtra kulturore ku prezantohen shkurt botimet e reja, është vitrina e librit për librin më të shitur, në të rrallë gjendet ndonjë recension, etj. Të tjerat ose merren nga gazeta e agjenci lajmesh të tjera, ose janë lajme të përkthyera.

Ajo që është e rëndësishme të thuhet është se kjo gazetë, pothuaj, u jep shumë pak hapësirë krijuesve të rinj, e sa për stimulim mos të flasim hiç.

Kurse gazetat e tjera, si "Express", "Lajm", "Epoka e Re" dhe "Infopress", edhe pse kanë faqe për sektorin e kulturës, disa sosh edhe shtojcën kulturore, më shumë merren me shkrime protokollare, përkthime të ndryshme, se sa me probleme të strukturës dhe gjendjes kulturore në Kosovë. Marrë në përgjithësi, kultura dhe sfera e saj e larmishme nuk e ka hapësirën, por edhe përkushtimin e duhur, në shtypin ditor kosovar. Edhe pse në këtë aspekt nuk mungojnë iniciativat për ndryshimin e gjendjes së përgjithshme, megjithatë hapësira e ngushtë kulturore për të rinjtë dhe artdashësit si edhe mungesa e stimulimit, bëjnë që kjo gjendje të jetë e palakmueshme edhe për një kohë të gjatë.

Ndryshimi do të duhet të ndodhë, por shtrohet pikëpyetja e madhe 'kur'? Përgjigjja si duket ka mbetur te formula e famshme, që tashmë e dëgjojmë shpesh "faji është jetim"! ■



Vargu im

Imer TOPANICA

Vargu im

Ti je i vetmi trekëmbësh në të cilin po e var veten çdo ditë
Për t'mos jetuar me marrëzitë e të tjerëve

Vargu im
Ti je Deti i Vdekur në të cilin mbytem unë

O vargu im
Ti je pakoja me kujtimet e shterura
Në të cilin shpresoj ta kujtoj të bukurën, prehjen

Ti je porta e fundit
Në të cilën unë trokas për të hyrë
Që t'mos më lagë ky shi i mërzitshëm

Vargu im i lodhur
Kënga ime e vetme…

Stinë

Kam vrapuar mes dy stinëve
Gjethet që binin ishin si ushtarë e mi që vdisnin në betejë
Dhe ty nuk të kam gjetur

Kam vrapuar i ndrydhur mes ngjyrave të zbehta
I pështjellur me shi dhe shtrëngatë
I rrënuar por s'jam ndalur
Dhe ty nuk të kam gjetur

Jam zhytur mes dallgëve mes tërbimit të detit
Atje thellë
Mes ngjyrave të errësuara të kaltra
Dhe ty nuk të kam gjetur

Kam shkëlqyer mes reklamave në rrugët e mbushura kalimtar
Trupi im është thyer i pasqyruar mes gjëmave
Ah, ç'jetë, dhe prapë ty nuk të kam gjetur
Jam si një bust hundëthyer që shikon thatë rrugën e vrarë

Kam kërkuar mes vargjesh, mes tingujsh mes trishtimit
Dhe vuajtja e dhimbja asgjë nga ti nuk më solli
As edhe kujtimin e plotë
Imazhi yt më është përgjysmuar në kujës
Dhe prapë ti nuk kthehesh!

Pse ike?
Si një vezullim mbi sipërfaqe deti
Rreze që luajte me valët e mia
Pse ike?
Unë nuk jam qiell me sy që mund të t'shikoj
Teksa strukesh në epshin tënd të mbështjellur me një të huaj
Dhe të çmallem me këtë pamje...
Ah, si s'kam fuqi as të t'mallkoj...

URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI

"Pema që shkulet e mbillet shpesh, nuk lëshon dot rrënjë."
Fernandos de Rohas (1465-1541, shkrimtar spanjoll)

"Era e fik qiriun, por edhe e ndez zjarrin."
Fransua de Laroshfuko (1613-1680, shkrimtar francez)

"Budallenjtë e mëdhenj dhe të mençurit e mëdhenj janë të padëmshëm. Të rrezikshëm janë gjysmë budallenjtë dhe gjysmë të mençurit."
Aleksandër Fredro (1793-1876, dramaturg polak)

"Mos i beso njeriut që flet mirë për të gjithë!"
Xon Kollinz (1848-1908, studiues anglez)

"Po u përpoqe t'u pëlqesh të gjithëve, në fund të fundit nuk do t'i pëlqesh askujt"
Arturo Graf (1848-1913, shkrimtar, historian dhe filolog italian)

"Për të kuptuar se qielli kudo është i kaltër, nuk është nevoja të bësh një udhëtim rreth globit."
Johan Volfgang Gëte (1749-1832, poet gjerman)

"Ah, sikur rinia të dinte e pleqëria të mundte."
Anri Etjen (1531-1598, shkrimtar, poliglot, filolog dhe përkthyes francez)



Apendiciti (zorra qorre) mund ta marrë jetën

Iliriana ALLOQI &
Bernard TAHIRBEGOLLI




Apendiciti është infektimi i një pjese shtojcë të zorrës së trashë që quhet apendiks, ose si njihet në popull "zorra qorre". Më tepër shfaqet te fëmijët, por ndodh edhe te të rriturit. Te kafshët apendiksi luan një rol të madh në shpërbërjen dhe tretjen e ushqimeve me burim bimor. Ndërsa te njeriu kjo shtojcë e zorrës nuk ka ndonjë rëndësi të veçantë dhe ne mund të jetojmë edhe pa të pa asnjë lloj problemi. Apendiciti mund të shkaktohet nga ndonjë infeksion ose nga diçka që bllokon sistemin tretës. Nuk dihet qartësisht se përse ndodh infeksioni, por një prej teorive është se bakteret që gjenden normalisht në rrugët e tretjes pushtojnë muret e apendiksit, si rezultat i dobësimit të sistemit mbrojtës të trupit dhe shkaktojnë infeksion.

Si zhvillohet ky infeksion?

Sipas mjekëve, mekanizmi i zhvillimit të kësaj sëmundje kalon në disa faza, duke filluar nga bllokimi i hapësirës brenda apendiksit, që çon në shumëzimin e shpejtë të mikrobeve të tij. Pas kësaj faze, tendosja e apendiksit çon në rritje të presionit venoz në të dhe komprometimi i furnizimit me gjak çon në edemë (fryrje) të mukozës. Nga prishja e mukozës bëhet vërshimi i baktereve dhe trashja e pareteve të apendiksit. Faza përfundimtare e zhvillimit te apendiksit është kur ai shfaqet tejet i fryrë e i zmadhuar. Më pas çahet dhe përmbajtja e tij me qelb derdhet e lirë në hapësirën e barkut.

Kur dyshohet që jemi të sëmurë nga apendiksi?



Një ndër shenjat që sinjalizon shfaqjen e apendiksit është dhimbja, e cila për 4 deri në 6 orë lëviz nga zona rreth kërthizës drejt zonës së djathtë, duke u ulur poshtë. Kjo dhimbje në kuadratin e poshtëm të djathtë të barkut shtohet nga kollitja, lëvizjet dhe goditja në anën e kundërt. Një shenjë tjetër, që vihet re në rastet kur i sëmuri është i prekur nga apendiciti janë edhe të vjellat ose të përzierat. Shpesh këta njerëz kanë mungesë të oreksit si dhe temperaturë deri në 37.4 gradë. Megjithatë zona e dhimbjes varion shumë nga vetë vendosja e apendiksit. Për shembull, pacienti paraqitet vetëm me probleme të dizurisë, në qoftë se apendiksi është i vendosur poshtë, duke ngacmuar fshikëzën e urinës. Të prekurit nga apendiciti kanë rritje të rruazave të bardha të gjakut nga 10 mijë në 20 mijë. Shpesh njerëzit që vuajnë nga kjo sëmundje kanë ndërlikime të ndryshme. Ndër më të rrezikshmet është çarja e apendiksit, i cili çon në infektim masiv të organeve të barkut, për shkak të qelbit që ai përmban. Një rrezik është edhe infektimi i cipës së barkut, për shkak të qelbit si dhe absesi rreth tij.

Veçoritë e apendicitit tek fëmijët

Më lart cekëm se infeksioni i apendiksit ndodh kryesisht te moshat e



reja. Fëmijët zakonisht përshkruajnë një dhimbje të madhe në qendër të barkut që herë vjen dhe herë ikën. Më vonë dhimbja zhvendoset në krahun e djathtë poshtë barkut dhe përkeqësohet. Të sëmurët kanë humbje oreksi dhe ndonjëherë vjellin, por këto vjellje nuk janë të mëdha. Mund të kenë probleme me jashtëqitjen ose mund të kenë diarre. Fëmija mund të ketë temperaturë të lartë dhe mund të ketë gjuhë të thatë, fytyrë të këputur, të rrijë shtrirë pa lëvizur dhe të mos marrë frymë plotësisht për shkak të dhimbjes. Por në disa raste, duhet të tregoheni tepër të vëmendshëm ndaj ankesave të fëmijëve për dhimbje barku, pasi ndonjëherë simptomat e apendicitit nuk janë të rregullta dhe sa herë që fëmija ka dhimbje të forta në bark, duhet konsideruar mundësia e apendicitit (për këtë arsye kontaktoni mjekun menjëherë).

Si diagnostifikohet infeksioni i apendiksit?

Të dalluarit e apendicitit sa më parë që të jetë e mundur është shumë i rëndësishëm, sepse nëse ai plas, përmbajtja e tij shpërndahet në membranën që mban organet në pozicione dhe pastaj mund të kemi ndërlikime të rënda. Diagnoza fillestare mund të gabohet lehtë dhe gjysma e atyre personave që janë operuar nuk kanë pasur apendicit. Mund të ngatërrohet me helmimin nga ushqimi, ënjtjen e gjëndrave të limfës në bark dhe infeksionet e rrugëve urinare, për arsye të shenjave të njëjta paralajmëruese. Për të dalluar apendicitin, mjekët ekspertë përdorin këtë mënyre: Vendosin gishtin tregues të njërës dorë në pozicionin e apendiksit dhe duke e goditur me gishtin tregues të dorës tjetër, mbi të ndihet një zhurmë që ndryshon nëse ka ajër ose është e mbushur. Nëse i thua një personi të hidhet nga një lartësi sa një shkallë me këmbën e djathtë, në mbi 90 për qind të rasteve ai person bie në tokë nga dhimbja nëse është i prekur nga apendiciti. Ekzistojnë edhe teste të tjera, të cilat i përdorin ekspertët e ndryshëm të kësaj fushe për të diagnostikuar një infeksion të apendiksit.

Mirëpo besohet që në të ardhmen nuk do ta heqim apendiksin vetëm kur të ndiejmë dhimbje në bark, pasi një test i thjeshtë mund të na tregojë nëse bëhet fjalë për një infeksion të apendiksit apo jo. Kërkuesit e "Children's Hospital"-it në Boston kanë identifikuar në urinë një proteinë që mund të shërbejë si "spiune" e problemeve me apendicitin. Bëhet fjalë për një nga urgjencat më të shpeshta të kirurgjisë pediatrike, kur vonimi i ndërhyrjes kirurgjike mund të çojë deri në vdekjen e të sëmurit. Sipas kërkuesve, proteina LRG është treguesi më i saktë i zbuluar deri tani për apendicitin. Ky zbulim është publikuar në revistën shkencore "Annals of Emergency".

Si trajtohet ky infeksion?

Në rast të dhimbjeve të mëdha të barkut, mos merrni asgjë për të ngrënë dhe për të pirë e sidomos mos praktikoni të merrni qetësues për dhimbje, pasi këto medikamente vërtet e zvogëlojnë dhimbjen, mirëpo, në anën tjetër, procesi vetëm sa zhvillohet dhe pastaj mund të komplikohet. Ju kontaktoni menjëherë mjekun në mënyrë që të largoni dyshimin e një infeksioni të mundshëm të apendiksit.

Nëse vërtetohet apendiciti, ndërhyrja urgjente kirurgjike (apendektomi-heqja e apendiksit) është mënyra e vetme e kurimit të suksesshëm të këtij infeksioni. Gjithashtu është shumë e nevojshme ta heqim apendicitin para se të çahet. Në qoftë se çahet, lëngjet e infektuara përhapen në bark, gjë që sjell infektimin e cipës së barkut, të organeve të barkut, të legenit e po ashtu mund të sjellë shumë probleme të mëvonshme, si moslindjen e fëmijëve te femrat. Në qoftë se apendiciti nuk trajtohet mund të sjellë edhe vdekjen. Të sëmurëve pas ndërhyrjes kirurgjike u jepen antibiotikë, qetësues dhe lëngje intravenoze. Fëmijët bëhen mirë disa ditë pas operacionit, por ndodh të ketë edhe infeksione të mëtejme (nëse zona nuk është pastruar mirë, ose nëse nuk është dhënë antibiotiku i duhur). Në qoftë se jeni të shqetësuar për shëndetin tuaj pas operimit menjëherë duhet të bëni kontroll te mjeku.

Sa më herët që zbulohet ky infeksion dhe sa më korrekt që mjekohet, aq më të vogla janë komplikimet dhe aq më shpejt pacienti e merr veten pas trajtimit. ■

Cila është liga më e mirë në botë?


Sezonin e parafundit, Premier League ishte më dominuesja në Evropë dhe në botë, me Manchester United që fitoi Ligën e Kampionëve dhe më pas edhe Kupën Botërore të Klubeve



Alban BILALLI

Premier liga angleze është një nga ligat më të forta në botë. Edhe në sezonin e kaluar patëm tre ekipe angleze në çerekfinale të garës evropiane, por në finale arriti të triumfojë një ekip spanjoll, Barcelona. Disa media dhe simpatizues të futbollit filluan ta quajnë ligën e kampionëve “liga angleze”, ngase tri skuadra nga Anglia bënin pjesë në gjysmë finale. Barcelona ishte ajo që ua ndali hovin klubeve angleze, duke e mundur Çelzin në gjysmë finale, kurse Manchester Utd. në finale.

Në ligën e kampionëve, këtë sezon, pritet një luftë shumë më madhe ngase klubet italiane janë përforcuar, sidomos Interi dhe Juventusi, kurse në Spanjë, Reali i Madridit ka shpenzuar 250 milionë euro për blerjen e lojtarëve.



Cila është liga më e fortë

Pasi përfundoi afati kalimtar i futbollistëve do ta kemi shumë më lehtë të themi se cila është liga më e fortë në botë.

Me përforcimet më të fundit që bënë Real Madridi dhe Barcelona, në këtë ligë do t'i kemi katër futbollistët më të mirë në botë, Lionel Messi, Cristiano Ronaldo, Zlatan Ibrahimoviç dhe Kaka, dhe më me lehtësi mund ta quajmë La Ligën si ligë të yjeve. Pas Barcelonës, që dominoi sezonin e kaluar, me përforcimet e fundit Reali pritet ta bëjë edhe më ngazëlluese garën. Reali transferoi në radhët e veta Ronaldon, Kakan, Benzemen, Alonson etj.



Liga Premier

Liga angleze, viteve të fundit, është konsideruar si liga më e fuqishme e Evropës, me dy Liga të Kampionëve të fituara (Liverpool dhe Manchester United) dhe me pjesëmarrje në çdo finale në disa nga sezonet e fundit. Por këtë vit, kjo ligë mund të mposhtet nga La Liga spanjolle që përveç titullit të Ligës së Kampionëve i ka “vjedhur” edhe yjet më të mëdhenj të futbollit. Një gjë është përparësi e kësaj lige: top katërshi është shumë më i fuqishëm se në të gjitha ligat e tjera. Madje këtë vit pritet të shndërrohet në top pesësh, pasi Mancester City ka blerë disa lojtarë cilësorë, si Adebajor, Tevez, Berry, Ture, Leskot etj. Kurse Manchetser Unt. , Çelzi, Liverpuli dhe Arsenali nuk kanë bërë ndonjë blerje të madhe. Për më tepër, me përjashtim të Çelzit, tri skuadrat e tjera kanë mbetur pa lojtarët cilësorë, si Manchesteri pa Ronaldon dhe Tevezin, Liverpuli pa Alonson, Arsenali pa Adebajorin dhe Kolo Turen etj.





Seria A

Seria A së fundi ka humbur shumë prestigj dhe yje. Së pari, humbi imazhin pas skandaleve për montimin e ndeshjeve, pastaj me rënien e frekuentimit të stadiumeve, por, po ashtu, edhe për faktin se shumica e ekipeve kanë mungesë të yjeve të mëdha. Fakti se Interi ka fituar katër herë radhazi kampionatin, nuk e ndihmon këtë ligë. Dhe këtë sezon, i vetmi ekip që duket më i aftë për ta ndërprerë serinë e fitoreve të Interit është Juventusi, pasi ka blerë lojtarë mjaft cilësorë. Por për të arritur nivelin e dy ligave të mësipërme, futbolli italian ka nevojë për shumë investime.



Ligat e tjera

Bundesliga gjermane dhe Ligue 1 franceze, vazhdojnë të mbeten e katërta dhe e pesta në Evropë, mbase edhe në botë. Bundesliga ka mjaft potencial dhe shikueshmëri, por ka mungesë të yjeve, me përjashtim të Bayernit që arrin sadopak të kontribuojë në këtë drejtim (Riberi, Roben). Dominimi i Lyonit në Francë, po ashtu, ka bërë që kjo ligë ta humbasë vëmendjen, e cila mbase është rikthyer në edicionin e fundit, ku triumfoi Bordeaux. Marseja e ka shtuar apetitin për ta fituar kampionatin këtë edicion. Vitin e kaluar ajo ishte nënkampione.

Nga ligat e tjera evropiane, të spikatura janë edhe ato portugeze dhe holandeze. Këto liga më shumë veçohen për faktin se nga klubet e tyre dalin talente të mëdha të futbollit.

Ligat joevropiane

Liga braziliane dhe ajo argjentinase janë vendet prej nga kanë ardhur yjet më të mëdha të Evropës, përfshirë Messi, Sergio Aguero, Kaka, Robinho, Ronaldinho e Diego. Por fakti se ata i shesin vazhdimisht yjet në drejtim të klubeve evropiane, sigurisht se ndikon në kualitetin e tyre dhe i lënë këto liga në rend të dytë në krahasim me ato evropiane. Madje skuadra që shpallet kampion mund të ndodhë që të luftojë për ekzistencë vitin tjetër, ngase lojtarët kryesorë i shet në klubet e tjera për shuma të majme. ■

AUTOR: AGIM B. GASHI	QË VUAN NGA NJË SËMUNDJE E RËNDË	GAZETAR I NJOHUR SHQIPTAR	MONEDHA TURKE	NDIHMAT	KONCEPTI I ZARATUSTRËS PËR TOKËN	QËLLIMI I LARTË	MAGJISTRI	DITA E FUNDIT E TOKËS	LLOJ GURI I ÇMUAR	AUSTRIA	PJESË E LOJËS SË TENISIT	STOPIMI	INTERACTIVE VOICE RESPONSE	HAPËSIRA E LIRË QË RRETHON TOKËN	ATO QË KANË PËRCATITJE TË VEÇANTA ARSIMORE	
FOTO																INDIA
ISH-MINISTËR YNI										... VAND DER SAR (Shq.) / EKREM KRYEZIU						
ZBRITJE ÇMIMESH							LIBRAT E PARË / KALIT, REGJ									ÇELIKOSET
NËPËR ARA					KUNDËRSHTAR NË LUFTË / A?						LITRI / NOTË MUZIKORE		VEND NË SLLOVAKI / DESPOTIK			
REXHEP ISMAJLI			GJALPË / SLLOVENIA							FIJA E QIRIRIT (Sh.Pashq.) / KALIUMI						
E PANJOHURA NË MATEMATIKË					HENDEKU / NENAT									KLASA / ADRIAN KRASNIQI		
E PLOTË											PASURIA E PATUNDSHME					
	AZOTI / TONI		EDI MARFI / LATIN									I MPREHTË / VËNI NË AKORD				
LLOJ ËMBËLSIRE											KyÇ			DY ZANORE		
	MOLIBDENI / I KALENDARIT			TELEFONI / DËSHMORI, KODRA (Shq.)							KIRIBATI			LEJTNANT / MUAJ DIMRI		
LËNDË MËSIMORE SHKOLLORE (Pashq.)					E QESHUR TALLËSE						OKËSE					GRUP YNI MUZIKOR
AUSTRIA		MUHAMED ... / VEND NË SHBA									REOMIRI		MIRUPAFSHIM (Lit.) / NISESHTE			
PIJETORE											RAMADAN				LITRI / SHKOPINJTË	
ERANDA LIBOHOVA			ZAMBIA			KOPJOJ	EMNAKE E DEMIRIT	ASTATI	TEMPI		AI QË FALET PARA SAFIT TË PARË GJATË NAMAZIT					
NAMIK DOKLE			PJESË E SYRIT (Sh.Shq.) / YMERI (Variant)							PRINCIPATË ARABE / VEND NË TURQI						
TRIM E BUJAR				GRIMCOHET / GJENDJE SHPIRTËRORE					SAHIT KELMENDI / SUEDIA			AFËRDITA / PJESË E LIGJËRATËS				
FURNIZIM ME ARMË								DUKA I MADH (Mit.) / LEGJENDË						IRENA PAPAS / OLIVER KAN		
REPRIZË									LLOJ BIME BARISHTORE (Sh.Pashq.) / CILIN?							
JODI		I MJESHTËRISË SË TË FOLURIT / ANGSTREMI								PORTO RIKO / REPUBLIKA			NJË NGA VRASËSIT E CEZARIT / MUAJ			
GATI TË BINDEM					TJETËRSIM									NYJE E PËRPARME E MBIEMRAVE		